

E PËRDITSHME
E PAVARURDrejtor:
FAHRI BALLIU
Kryeredaktor:
ILIR NIKOLLANr. 189 (4254)
Viti XIV i botimit
(numri i parë doli
më 18.10.1997)E hënë,
12 korrik 2010

55

Adresa: Rruga
"Medar Shtylla",
qendra e biznesitTel: 04/2321364,
Tel: 04/2321366,
Fax: 04/2321365,
TiranëE-mail:
info@gazeta55.net,
gazeta55mail@
yahoo.com,Internet:
www.gazeta55.al
Çmimi 30 lekë
Greqi 1,5 EURO

OPINION/4

Milionerët dhe "mitralierët" e Ramës

Nga Feti Zeneli

Procesi i deklarimit të pasurive për vitin 2010 dokumentoi përfundimisht praninë e një grupi jo të vogël milionerësh në gjirin e grupit parlamentar të Partisë Socialiste, të dalë nga zgjedhjet e përgjithëshme të 28 qershorit 2009 në Shqipëri. Por "de facto", në këtë grup, mund të jenë edhe më shumë se 30 deputetë apo zyrtarë të lartë socialistë, të përfolur si të tillë deri në zyrat e Brukselit. Dyshimi të krijohet sapo shikon

"fukarallëkun" e kryetarit të PS-së, i cili është katandisur në "shtëpi me qira" dhe me "borxhe" për të përballuar koston e jetesës ditore apo këstin vjetor të kredisë bankare përgjatë vitit politikor që sapo u mbyll, përballë "agallëkut" të Ledi Shamkut alias Enkelejda Shkreli, bashkëshortes së "hyzmeqarit" të tij në KRRT-në e Bashkisë Tiranë, Artan Shkrelit, i njohur nga publikimet e ndryshme në shtyp si sekseri kryesor i Ramës për lejet e ndërimit së bashku

Zgjedhjet në PS i fitoi dhuna

Pas imponimit të djeshëm të njeriut të Gramoz Ruçit në Lushnje, dje ka qenë radha e policëve, prokurorëve dhe të "fortëve" të tjerë të Edvinit për të marrë në dorë degët e PS. Pa zgjedhje, dje në Tiranë është emëruar si kryesocialist ish-polici Pjerin Ndreu, ndërkohë që në Dibër ka qenë radha e ish-prokurorit Ulusi Manja. I gjithë procesi ka mbështetur ylberistët e dhunshëm, duke afruar shndërrimin e PS-së në një formacion të mirëfilltë paramilitar

Mungesa e transparencës dhe presionet verbale drejt anëtarësisë së thjeshtë socialiste, e konfirmojnë procesin e djeshëm të zgjedhjeve për drejtuesit lokalë në PS, si një farsë më vete



Bojkotohen zgjedhjet për kreun e PS-së së Tiranës, në qytetet e tjera fituan të "fortët" e Edvinit
Nga 280 anëtarë vetëm 156 kanë marrë pjesë në votimin e djeshëm ku u zgjodh Pjerin Ndreu si kryetar i PS-së për Tiranën

NË BRENDESI

PS, politikë me dy standarde, fillimisht dënoi vendimin për rritjen e pagave, tani i kundërvihet edhe shkurtimeve të shpenzimeve

Dy vendimet më të rëndësishme të qeverisë të javës së kaluar, për rritjen e pagave dhe pensioneve dhe shkurtimeve të shpenzimeve, për t'i paraprirë efekteve të krizës ekonomike globale, janë kthyer në shënjestër të opozitës shqiptare. Ish ministri i Financave Arben Malaj, u shpreh dje përmes një deklaratë emocionale dhe pa fijen e logjikës, se qeveria nuk duhet të kishte marrë një vendim të tillë, në një kohë kur homologët e tij dënuan më herët rritjen e pagave dhe pensioneve. "Një qeveri që shkurton me 9.5 përqind shpenzimet në to

POLITIKË

Berisha kujton masakrën e Srebrenicës: Gjenocidi më i egër i PasLuftës së Dytë Botërore, por xhelatët janë ende të lirë

Shefi i ekzekutivit e ka konsideruar ngjarjen e 15 viteve më parë si më mizoren, ndërsa ka dënuar faktin se autorët e vërtetë të masakrës janë ende të lirë

Kreu i Qeverisë shqiptare ka deklaruar dje me rastin e 15 vjetorit të masakrës masive të Srebrenicës se shpirtrat e fëmijëve, grave, të rinjve, të moshuarve, viktimat të Srebrenicës, kërkojnë nga njerëzit e lirë, qeveritë e tyre, OKB-ja, drejtësi.

Sipas kryeministri shqiptar, viktimat do të prehen të qetë vetëm atëherë kur vrasësit e tyre të marrin dënimin e merituar.

"Ata do të mund të prehen të qetë, vetëm atëherë kur xhelatët e tyre do të marrin dënimin më të rëndë që meritojnë. Sot është 15 vjetori i barbarisë më të pa parë, gjenocidit më të egër, më mizor, të pasluftës së dytë botërore, masakrës masive të Sre

FORUM

35 mijë biznese shqiptare në Itali

Zef Bushati, numri 2 i diplomacisë shqiptare në Itali flet për prezencën në rritje të bizneseve shqiptare në fqinjën e fuqishëm, përtej Adriatikut

"Gjate takimeve me faktore të rendesishme të biznesit italian, tani kemi se çfare permendim; konkretisht duke filluar që nga sistemi bankar, nepermjet prezencës së bankave italiane serioze e te forta e jo vetem në Itali por edhe në Europë si psh: "Intesa San Paolo", e deri tek "Banka Popullore Puglia e Basilicata", Banka Italiane e Zhvillimit... e po kështu në fushën e tregtisë, nepermjet shoqerive të njohura e me emër në Itali si Conad, Euronix, Oviessa, Coin, etj. ne fushën e industrisë, të shëndetësisë, arsimit, turizmit, bujqësisë", thotë Zef Bushati, sekretari i parë i ambasadës tonë në Romë.

Kohët e fundit në Shqipëri janë realizuar dhe po realizohen investime të mëdha. Por ajo që me ka befusuar dhe për të cilën po punoj me një pasion të vecantë është prezencën e bizneseve shqiptare në Itali, thotë Bushati. Nese me pyesni se çfare mund të veçoj si më të rendesishme në marrëdhëniet ekonomike mund të permend me mjaft kenaqësi e pse jo dhe me krenari, pikerisht faktin se simbas një

FORUM

Opinione të analistëve rreth përkeqësimit të marrëdhënieve Iran - Rusi

Nga Andre De Nesnera (VOA)

Loja me policë e hajdutë në degën socialiste të Tiranës

Redaksionale

**DOSSIER/
Familja e Taushanëve në rrjedhën e shekujve**

ALPET
ENERGJI POZITIVE

NOBEL
Shkolla 12-vjeçare jopublike

**Shkolla që sfidon të ardhmen
REGJISTRIMET FILLUAN**

Kontakto: 0692099430; 0692076801

AMADEUS GROUP

Motorgjeneratore - Motore të fuqije të ndryshme - Materiale Elektrike
UPS - Radrizzatore - Invertera - Transformatore - Filtra dhe Lubrifikante
Centrale Hidrike dhe Termike

Power Generation Engine Filtration SIEMENS socomec

www.amadeus-al.com tel. +355 4 22 74 500 fax. +355 4 22 24 279 Our energy working for you.

ALPET
ENERGJI POZITIVE

Masakra e Srebrenicës, BE thirrje për pajtim në Ballkan

Ashton dhe Fule, përmes një mesazhi ngushëllojnë familjarët e viktimave ndërsa vlerësojnë masakrën si njollosje të vlerave njerëzore

Përfaqësuesja e Lartë e Unionit, Catherine Ashton, dhe Komisioneri për Zgjerimin, Stefan Fule, bëjnë thirrje për pajtim në ditët përkujtimore të Masakrës së Srebrenicës.

Në komunikatën e përbashkët për shtyp, ata u bëjnë homazh viktimave dhe shprehin ngushëllimet ndaj familjarëve fillimisht, duke kujtuar se krimet e tmerrshme që u bënë 15 vite më parë në Srebrenicë njollosën vlerat, parimet e të drejtat themelore që respekton Europa.

“Srebrenica është sot një përkujtim i heshtur për atë që nuk duhej të kishte ndodhur asnjëherë e që nuk duhet përsëritur më kurrë”- shprehen dy

zyrtaret e lartë europianë.

Duke njohur se dhimbja e pikëllimi do t'i shoqëroje deri në ditën e fundit të jetës të mbijetuarit e masakrës, Ashton e Fule nënvizojnë se pajtimi është premtim që duhet mbajtur për të ardhmen e gjeneratave.

“Bashkëpunimi i plotë me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve për ish-Jugosllavinë mbetet nevojë thelbësore dhe urgjente. Rikthimi dhe integrimi social i të zhvendosurve gjatë luftës është po ashtu pjesë e procesit për rivendosjen e të drejtave individuale dhe ndërtimin e të ardhmes së përbashkët duke sfiduar krimet e luftës”- shprehet Përfaqësuesja e

Lartë e Komisioneri për Zgjerimin. Në 6 dekadat e fundit, sipas tyre, eksperiencia europiane ka dëshmuar se një perspektivë e përbashkët mund të shërojë shumë plagë dhe të krijojë kushtet për prosperitet e të ardhme më të mirë.

“Kjo është ajo që do BE për të mbijetuarit e Srebrenicës, dhe për të gjithë qytetarët e Ballkanit Perëndimor. Drejtësia për viktimat të ndiqet nga gjykatat dhe të ketë një të ardhme më të mirë europiane për të gjithë, duke siguruar paqe e stabilitet dhe shtetin ligjor”, përfundojnë mesazhin e përbashkët Përfaqësuesja e Lartë Ashton dhe Komisioneri Fule.



Zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm Ilir Meta, i pranishëm në ceremoninë përkujtimore në Srebrenicë

Krimi më i madh, Ballkani të lerë pas historinë e dhimbshme dhe të ndërtojë të ardhmen evropiane

Zv/kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Ilir Meta mori pjesë në ceremoninë e 15 vjetorit të tragjedisë së Srebrenicës në Bosnje Hercegovinë, ku u rivarrosën eshtrat e 775 personave të identifikuar. Në ceremoni, kryediplomati shqiptar, Meta u prit nga Presidenti i Bosnjes Haris Silajdžić. Zv/kryeministri dhe ministri i Jashtëm, u takua edhe me familjarë të viktimave si dhe vizitoi ekspozitën me rastin e përkujtimit.

Të pranishëm në këtë ceremoni, me të cilët zëvendëskryeministri Meta ka zhvilluar dhe takime kanë qenë kryeministri turk, Rexhep Taip Erdogan, ministri i Jashtëm francez, Bernard Kushner dhe presidenti serb, Boris Tadić. Meta bëri homazhe dhe vendosi një kurorë në përmendore. Në fund të ceremonisë, Meta dha një prononcim për mediat, duke deklaruar se masakra e Srebrenicës, është ngjarja më e dhimbshme në të gjithë Evropën, pas Luftës së Dytë Botërore. Zv/kryeministri shqiptar, vuri në dukje se vendet e rajonit duhet të shpëtohen nga mentaliteti i dhimbshëm i së shkuarës dhe të shohin drejt së ardhmes.

“Nuk mund të mungojnë në këtë përvjetor shumë të rëndësishëm të Tragjedisë së Srebrenicës, që është krimi më i madh kundër njerëzimit që pas luftës së dytë botërore.

Jam këtu për të shprehur solidaritetin tonë me të gjithë popullin e Bosnjes dhe me familjarët e viktimave, por njëkohësisht edhe të theksoj angazhimin tonë, që duke përkujtuar ngjarje te tilla kaq tragjike, që nuk kanë ndodhur shumë larg në të kaluarën.

Njëkohësisht, duhet të mësojmë se si të mos përsëriten më ngjarje të tilla, dhe njëkohësisht të garantojmë një të ardhme të sigurt për të gjithë qytetarët e Bosnjes, qytetarët e rajonit dhe për fëmijët tanë”- u shpreh zv/kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Ilir Meta.

Masakra e Srebrenicës njihet si një nga gjenocidet më të përgjakshme të historisë së njerëzimit, ku afro 8 mijë myslimanë të Bosnje Hercegovinës u masakruar nga ushtria serbe e urdhëruar nga Slobodan Miloshević dhe udhëheqësi i serbëve të Bosnjes, Ratko Mlladić.

Ceremonia

Të paktën 50 000 persona morën pjesë dje në 15-vjetorin e masakrës së Srebrenicës, në Bosnje, ku humbën jetën rreth 8 000 myslimanë boshnjakë, në korrik 1995.

Masakra e kryer nga forcat serb-boshnjake në fund të luftës së Bosnjes (1992-95) është konsideruar gjenocid nga drejtësia ndërkombëtare.

Ceremonitë civile dhe fetare filluan në orët e para të mëngjesit të djeshëm, për të vazhduar gjatë gjithë ditës. Ato filluan me varrosjen e eshtrave të 775 viktimave të masakrës, në qendrën memoriale të Potocarit, ku aktualisht ndodhen edhe 3 749 viktimat e tjera.

Në këtë ceremoni morën fjalën kryeministri belg, Yves Leterme, vendi i të cilit ka presidencën e radhës të BE-së si edhe kryeministri turk, Recep Tayyip Erdogan.

Në ceremoni ishin të pranishëm ministri i Jashtëm francez, Bernard Kouchner dhe presidenti serb, Boris Tadić.

Me një rezolutë të miratuar në mars, parlamenti serb ka dënuar masakrën e Srebrenicës, por nuk ka guxuar ta konsiderojë atë si gjenocid. Pavarësisht qëndrimit të politikës serbe, masakra e 11 korrikut 1995-ë vazhdon të dënohet nga eksponentët ndërkombëtarë.

Berisha kujton masakrën e Srebrenicës: Gjenocidi më i egër i PasLuftës së Dytë Botërore, por xhelatët janë ende të lirë

Shefi i ekzekutivit e ka konsideruar ngjarjen e 15 viteve më parë si më mizoren, ndërsa ka dënuar faktin se autorët e vërtetë të masakrës janë ende të lirë

Kreu i Qeverisë shqiptare ka deklaruar dje me rastin e 15 vjetorit të masakrës masive të Srebrenicës se shpirtrat e fëmijëve, grave, të rinjve, të moshuarve, viktimat të Srebrenicës, kërkojnë nga njerëzit e lirë, qeveritë e tyre, OKB-ja, drejtësi.

Sipas kryeministri shqiptar, viktimat do të prehen të qetë vetëm atëherë kur vrasësit e tyre të marrin dënimin e merituar.

“Ata do të mund të prehen të qetë, vetëm atëherë kur xhelatët e tyre do të marrin dënimin më të rëndë që meritojnë. Sot është 15 vjetori i barbarisë më të pa parë, gjenocidit më të egër, më mizor, të pasluftës së dytë botërore, masakrës masive të Srebrenicës, në të cilën mbi 8 mijë civilë, burra, gra, fëmijë, të vendosur nën mbrojtjen e trupave të OKB, u ekzekutuan dhe shfarosën nga falangat e Milosheviçit e Mlladiçit, vetëm e vetëm për përkatësinë e tyre etnike dhe besimin e tyre fetar”- shpreh në mesazhin e tij, kryeministri Berisha.

Sipas shefit të qeverisë, në këtë përvjetor zije, dhimbja, përgjegjësia, por edhe lëndimi i ndërgjegjes



së njerëzimit, për këto mijëra e mijëra jetë të pafajshme, të rrëmbyera mizorisht, janë më të mëdha se 15 vjet më parë.

“Kjo sepse ende, autori kryesor, kryexhelati i këtij gjenocidi, Radko Mlladić dhe shumica e xhelatëve të saj, gjenden të lirë. Shpirtrat e fëmijëve, grave, të rinjve, të

moshuarve, viktimat të Srebrenicës, kërkojnë nga njerëzit e lirë, qeveritë e tyre, OKB-ja, drejtësi. Ata do të mund të prehen të qetë, vetëm atëherë kur xhelatët e tyre do të marrin dënimin më të rëndë që meritojnë”- deklaroi më tej në mesazhin e tij kryeministri Sali Berisha.



Zgjedhjet në PS i fitoi dhuna

Pas imponimit të djeshëm të njeriut të Gramoz Ruçit në Lushnje, dje ka qenë radha e policëve, prokurorëve dhe të "fortëve" të tjerë të Edvinit për të marrë në dorë degët e PS. Pa zgjedhje, dje në Tiranë është emëruar si kryesocialist ish-polici Pjerin Ndreu, ndërkohë që në Dibër ka qenë radha e ish-prokurorit Ulusi Manja. I gjithë procesi ka mbështetur ylberistët e dhunshëm, duke afruar shndërrimin e PS-së në një formacion të mirëfilltë paramilitar

Mungesa e transparencës dhe presionet verbale drejt anëtarësisë së thjeshtë socialiste, e konfirmojnë procesin e djeshëm të zgjedhjeve për drejtuesit lokalë në PS, si një farsë më vete, veç rrugaçllëkut 12 mujor rrugëve të Shqipërisë. Ndonëse baza socialiste dënoi prej ditësh me radhë, vendimin e dyzuar të Edi Ramës për të emëruar në postet drejtuese lokale të PS-së njerëz të tij apo të quajtur ndryshe oborrtarë të Pezës, kryesocialisti nuk u tërhoq nga përzgjedhja e tij, duke i shpallur kështu sfidë mbështetësve elektoralë.

Angazhimi i Gramoz Ruçit për shtypjen e protestës së socialistëve në bazë, ka qenë e efektshme. Gramoz Ruçi, jo vetëm ia ka arritur të "shuajë zërat kundër", por ju ka dhënë një mësim të mirë protestuesve, kur ka sanksionuar në krye të degëve lokale të PS-së, persona, që tashmë e në vazhdim e mundësojnë vetë të mos lejojnë kundërshtimet e "ideve" të Edi Ramës. Këtë e ka mundësuar në mënyrën më të thjeshtë të mundshëm, duke vendosur



në krye të degëve të PS lokale persona me "begrund", nga Forcat e armatosura.

Pas ndikimit shembullor të Gramoz Ruçit në Lushnje, kur përdhunshëm emëroi kryetar të degës së PS-së, Bujar Çelën, dje, falë "ndikimit" të tij, Edi Rama ka një arsye më shumë të bëjë gjumin e qetë, pse në Dibër e në Tiranë, siguroi të emëroi persona të besuar.

Në Dibër, nga dje, degën e PS-së do e drejtojë ish-prokurori Ulusi Manja, ndërsa, "fitorja më e madhe"

zgjedhore e Edi Ramës, që pas ardhjes në krye të PS-së, është emërimi në krye të degës së PS në Tiranë, të Pjerin Ndreut, ish-polici me një karrierë, ku më shumë mbahet mend për njollosje që i ka bërë uniformës së policit.

Edi Rama emëroi si favorit për drejtimin e PS-së në Tiranë ish kryepolicin Pjerin Ndreu, i njohur për agresivitetin e tij dhe shtrydhjen e mendimit të lirë, gjë e cila i mundëson kryetarit të socialistëve, zvogëlimin e zërit kri-

tik. Po ashtu, e njëjta skemë mafioze është përsëritur dhe në PS-në e degës Lushnje, atje ku Bujar Çela, ka marrë bekimin e Ramës, për të shfrytëzuar çdo hapësirë, në minimizimin e qëndrimit refraktar dhe vënien e strukturave nën kontroll të plotë.

Metodika autokratike dhe emërimi në poste të rëndësishme drejtimi, përmes një veprimi të afër me nepotizmin. Edi Rama, i ndikuar fort nga efekti "Kasandra", pra parashikimi i një fatkeqësie të afërt, që do të

thotë humbje të favoreve pushtetare, të cilat deri më tani ka arritur t'i koleksionojë përmes vrimave të Bashkisë së Tiranës, ka bërë lëvizje të zgjuara, duke hedhur "rrjetën e të fortëve", për të eliminuar zërat radikalë dhe kritikët e partisë.

I lodhur ndjeshëm muajt e fundit, përmes ecejakeve rrugë-parlament-rrugë dhe sulmeve të pamëshirshme nga baza socialiste, e detyruan Ramën të shtijë në dorë shtigjet e radikalizmit, duke i mohuar kështu përfundimisht bazën socialiste mendimin e lirë dhe të drejtën e protestës në rastet kur vendimi i kryetarit konsiderohet i gabuar. Kësisoj, nuk mund të flitet më për një të majtë të prirur drejt efekteve të hollësishme politike, por mund të quhet fare lehtë si një forcë eunuke pa ide, pa logjikë dhe pa plan operimi.

Ëndrrat e Edi Ramës me Kasandrën, nuk është mirëfillti rreziku që ai ndjen apo thënë më lehtë skarciteti politik, por tmerri i një kryqëzimi të egër që mund t'i vijë nga përfaqësuesit e vërtetë të vlerave socialiste.



Ministri i Drejtësisë, Bujar Nishani

Duhet kthyer besimi i qytetarëve te Drejtësia

Ministri i Drejtësisë, Bujar Nishani, pohon se do të zbatohet një strategji për të kthyer besimin e njerëzve tek sistemi gjyqësor.

Gjyqësori vazhdon të jetë institucioni më pak i besueshëm nga publiku, për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit. Sipas Nishanit, gjykatësit që nuk kanë integritetin e duhur moral nuk duhet të ngarkohen me çështje të rëndësishme.

Ministri theksoi se brenda sistemit gjyqësor ka gjyqtarë dhe prokurorë që kanë integritet të lartë profesional.

"Dhënia e mbështetjes këtij kontigjenti, besoj se do të fillojë të bëjë dallimin vetë brenda sistemit", ka pohuar Nishani.

Duke folur për Gjykatën Administrative, numri një i dikasterit të drejtësisë nënvizoi se ajo do të jetë një mundësi më shumë për qytetarët që të verifikojnë në mënyrë elektronike pretendimet e tyre.

"Çdo qytetar që mund të ketë pretendime për shkelje, mund ta krahasojë pretendimin e tij me sistemin", shtoi ai.

Bojkotohen zgjedhjet për kreun e PS-së së Tiranës, në qytetet e tjera fituan të "fortët" e Edvinit

Nga 280 anëtarë vetëm 156 kanë marrë pjesë në votimin e djeshëm, ku u zgjodh Pjerin Ndreu si kryetar i PS-së për Tiranën

Ashtu siç edhe paralajmëroi, baza socialiste ndëshkoi dje Edi Ramën, duke bojkotuar zgjedhjet për krerët e rinj të partisë në rrethe. Në të gjitha njësitë lokale të PS-së në rrethe, është vërejtur pjesëmarrje minimale e anëtarëve të Asamblesë, në shenjë proteste për emërimin në poste drejtuese të oborrtarëve të zgjedhur nga Rama dhe jo ata që u aprovuan nga anëtarësia.

Lista 100 emërore e propozuar nga baza, të përzgjedhur me kujdes dhe duke respektuar kriteret e statutit dhe funksionimit të partisë, u rrëzua spontanisht gjatë një mbledhje të grupit parlamentar socialist, ku nuk munguan dhe kritikë e ashpra në drejtim të drejtuesve të partisë, krye-

sisht Ramës, i cili u akuzua se po e kthen PS-në në një "oborr" të mbushur me njerëzit e Pezës. Kësisoj, krahas aktivizimit të bojkotit dhe parashikimeve për rinisjen e protestave në shtator, lëvizje këto që u kundërshtuan fort nga përfaqësuesit e brendshëm të PS-së, një krisje e re duket në horizont, e cila këtë radhë mund të kapërcejë çdo parashikim. F akti që selia rozë nuk respekton vendimin e forumeve të saj drejtuese, përbën një precedent më vete në marrëdhëniet me strukturat dhe bazën në rrethe. Kjo bëhet edhe më e qëndrueshme kur mendojmë se funksionaliteti i një force politike varet definitivisht nga vendimet e bazës, por në momentin kur këto shpërfillen dhe hidhen



poshtë si fletërrufe që bien ndesh me parimet pezake të Ramës me shokë, atëherë do të thotë qartësisht se e ardhmja e PS-së është shkrirja. Por, gjithashtu është fakt, që Edi Rama kërkon me ngulm të ndërrojë çdo identitet të PS-së tradicionale, PS-së së themeluar nga Fatos Nano, për ta kthyer atë në një forcë politike as e majtë as e djathtë,

por thjesht një strehë e 99-shave, nisur nga martesja e fundit Rama-Veliaj. Prandaj, nuk është e rastësishme numri i pakët i anëtarëve të PS-së që marrin pjesë në votim, për zgjedhjen e strukturave drejtuese, pasi një veprim i tillë ishte paralajmëruar prej disa ditësh. E njëjta skenë është përsëritur jo vetëm në Tiranë, por edhe në qytete të

ndryshme të vendit.

Zemërimi i anëtarësisë socialiste, duke bojkotuar zgjedhjen e kryetarëve të rinj të partisë, është ende në hapat fillestarë, pasi të tjera vendime kokëforta të bazës socialiste parashikohen të vihet në jetë, në varësi të qëndrimit të Edi Ramës dhe oborrtarëve pezakë, të prirur për përjashtimin e vlerave të vërteta të së majtës.

Kongresmeni Glenn Nye, i vetmi anëtar i Kongresit Amerikan, që di të flasë shqip

Nga Beqir Sina

Në lokalin e njohur në qendër të Nju Jorkut, "Club A Steakhouse", me sipërmarrës aktivistin e vjetër shqiptar, nga Vuthaj, Bruno Selimaj, më 8 korrik, Këshilli Kombëtar Shqiptaro Amerikan (KKSJA), bëri një fushatë tipike amerikane, fondmbledhëse, kësaj radhe për kongresmenin Glenn Nye, përfaqësues i Distriktit të dytë në Virxhinia, i cili, po rikandidon në këtë zonë elektorale, për një mandat të dytë në Kongres. Në takim morën pjesë aktivistë dhe veprimtarë të dalluar të komunitetit shqiptaro-amerikan, përfaqësues të Këshillit Kombëtar Shqiptaro -Amerikan (KKSJA), si dhe afaristë e biznesmenë të suksesshëm. Zoti Xhim Xhema, Harry Bajraktari, Cafo Boga, Nino Pjetri, Zenel Bajraktari, Patrick Devine, Lumi Hadri, si dhe kryetari i KKSJA-s, Martin Shkreli, e shfrytëzuan takimin me Kongresmenin Glenn Nye, për t'i shprehur atij dhe kongresmenit demokrat nga Nju Jorku, Eliot Engël, edhe njëherë mirënjohjen për mbështetjen e tyre, për një sërë çështjesh shqiptare, sidomos pavarësinë e Kosovës dhe anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Kryetari i KKSJA-së, Martin Shkreli, e vlerësoi lart kongresmenin Nye, veçanërisht për kontributin e dhënë për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Gjatë fjalës së tij veprimtari i dalluar Harry Bajraktari nënvizoi rëndësinë e vazhdimin të përfshirjes së SHBA-ve në Ballkan, sidomos në Kosovë, tash kur ende nuk është zgjidhur problemi i Mitrovicës. Bajraktari shprehu mirënjohje për mbështetjen e madhe që ka dhënë Presidenti Clinton, presidenti Bush si dhe kongresmenë, senatorë dhe zyrtarët e lartë të qeverisë amerikane, të cilët kanë dëshmuar besnikëri ndaj përpjekjes së kryesuar nga SHBA, për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës, si dhe anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Ndërsa veprimtari Cafo Boga, kërkoi nga kongresmenët Engel dhe Nye, mbështetjen konkrete në rajon nga SHBA-të, për të ndihmuar me zbatimin e "Marrëveshjeve për Implementimin", si në Maqedoni, ashtu edhe në Mal të Zi, Preshevë, Medvegje e Bujanoc. Të pranishmit kërkuan vazhdimin e përfshirjes amerikane në rajon.

Glenn Nye u betua si Përfaqësuesi i ri i Qarkut 2 nga Virxhinia, më 6 janar 2009. Ai është anëtar në Komitetin e Shërbimeve Ushtarake, atë të Dhomës dhe të Punëve të Komitetit të Veteranëve, si dhe ka shërbyer si kryetar i nënkomitetit të vogël, në Shtëpinë e Biznesit të Kontraktuesve dhe të Teknologjisë.

Ligjvënësi Glenn Nye, në këtë takim fondmbledhës, tregoi me krenari, se është i vetmi anëtar i Kongresit Amerikan që di të flasë shqip. "Kur më pyesin nëse jam me prejardhje shqiptare, unë u them se me shpirt jam shqiptar" thotë kongresmeni Nye, i cili gjuhën shqipe e ka mësuar gjatë qëndrimeve me punë në Kosovë e mes shqiptarëve në Maqedoni, përpara se të zgjidhej në Kongres si përfaqësues i shtetit të Virxhinias. Takimin e fundit me shqiptarët, ai tha se e pati në një nga mjediset e Kongresit amerikan më 28 prill, kur u përurua ekspozita me titull: "Nënë Tereza - Gonxhe Bojaxhi, simbol i gjallë i dashurisë dhe dinjitetit njerëzor", në prani të një numri anëtarësh të Kongresit si dhe përfaqësuesish të komunitetit shqiptaro-amerikan.

Milionerët dhe "mitralierët" e Ramës

Nga Feti Zeneli

Procesi i deklarimit të pasurive për vitin 2010 dokumentoi përfundimisht praninë e një grupi jo të vogël milionerësh në gjirin e grupit parlamentar të Partisë Socialiste, të dalë nga zgjedhjet e përgjithëshme të 28 qershorit 2009 në Shqipëri. Por "de facto", në këtë grup, mund të jenë edhe më shumë se 30 deputetë apo zyrtarë të lartë socialistë, të përfolur si të tillë deri në zyrat e Brukselit. Dyshimi të krijohet sapo shikon "fukarallëkun" e kryetarit të PS-së, i cili është katandisur në "shtëpi me qira" dhe me "borxhe" për të përballuar koston e jetesës ditore apo këstin vjetor të kredisë bankare përgjatë vitit politikor që sapo u mbyll, përballë "agallëkut" të Ledi Shamkut alias Enkelejda Shkreli, bashkëshortes së "hyzmeqarit" të tij në KRRT-në e Bashkisë Tiranë, Artan Shkreli, i njohur nga publikimet e ndryshme në shtyp si sekseri kryesor i Ramës për lejet e ndërtimeve së bashku me Alban Eftimin. Deputetja Shkreli ka në pronësi të saj; një apartament banimi (2+1), me sipërfaqe 140.8 metra katrorë, 12.7 metra katrorë ndërtesë në bashkëpronësi si dhe një vend parkimi me vlerë parkim 450 mijë lekë në Tiranë. Ndërkohë ajo disponon një banesë (2+1) në Berat, me sipërfaqe 69.9 metra, një banesë (3+1) në Golem, një truall në Mjull-Bathore me sipërfaqe 6 000 metra, një automjet tip BMË, 25 000 euro bizhuteri, etj. Pyetja që të vjen vetvetiu ndërmend në këtë rast është: Si ka mundësi që "çiraku" t'ia kalojë ustait edhe në pasuri, pa mirë në mjeshtëri?!

Të njëjtin dyshim krijon edhe kur kujton pasurinë marramendëse të Rudina Seserit, Shegushe Ligorit, Dashnor Pezës, Artan Gaçit, Hazir Gashit, Gjovalin Kadelit, etj., pa le më atë të Tom Doshit, Fidel Yllit apo biznesmenëve të tjerë me emër në Partinë Socialiste. Por, përveçse për numrin, dyshimi të lind edhe për përmasat e zvogëluara të pasurisë reale të milionerëve të majtë. Por më shumë se sa numri i të pasurve dhe volumi i pasurisë, në këtë rast, të tërheq vëmendjen fenomenin e "borgjezimit" të një partie të majtë. Përfaqësuesit e "vegjëlisë" apo "popullit të majtë", siç ka dëshirë ta quajë Edvin Rama elektoratin e vet, nuk janë më "të parët në sakrificë" e të fundit në pretendime, por disa "milionerë me flokët me briliantinë, unaza diamanti, me dhjetëra apartamente e makina të tipit të fundit", siç i ka etiketuar në një moment zemërimi, bashkëlufëtari i tyre Erion Braçe.

Fenomeni i milionerizimit të Partisë Socialiste është "...binjak me historinë që e lindi..." këtë forcë politike në maternitetin e pluralizimit në Shqipëri, nën kujdesin e "gjinologut" komunist, Ramiz Alia, i cili i ushqeu majtistët e "mitur" të demokracisë me "qumështin" e pushtetit ekonomik, në vend të atij politik. Të gjithë e kemi parasysh porosinë e tij "gorbaçoviane" në një nga mbledhjet e fundit të forumeve të larta të PPSH-së për ta mbushur boshllëkun e humbjes së pushtetit politik me "pushtet ekonomik". Nuk është rastësi që shumica dërrmuese



e dyqaneve të tregtisë apo shërbimit komunal të kohës së monizmit, në fillim të viteve '90, përfunduan në duartë e të majtëve, që u bënë "promotorë" të aktivitetit privat, në një kohë që tërë jetën e tyre ishin shquar si punonjës apo nëpunës të zellshëm të kolektivizmit. Po kështu, nuk është rastësi që biznesmeni i parë në Shqipëri u bë ish Ministri i Tregtisë së Jashtme të kohës së monizmit, Shane Korbeci; sikundër mund të themi të njëjtin gjë për dhjetëra zyrtarë të tjerë të lartë apo diplomatë të regjimit komunist. Në vitet e "socializmit të dytë" shqiptarë, në vitet 1997-2005, Fatos Nano e pasuroi në kushte të reja këtë tezë të paraardhësit të tij, i cili kooptoi në strukturat e larta të PS-së biznesmenët e parë të "paparti". Qëllimi ishte rifreskimi i partisë me "gjak të ri" milionerësh, ndërkohë që milionerëve të vjetër të tipit "Baçi-Naçi" u kishte nxjerrë bojën si të korruptuar në mbledhjet e shumta të "kongresmenëve" shqiptarë. Pra, Nano e përdori këtë manovër politike si një mundësi "reformimi" të strukturave të PS-së për të shtuar jetëgjatësinë e pushtetit të tij, të dobësuar seriozisht nga prania e korrupsionit në të gjithë nivelet e qeverisjes të asaj kohe. Ndërsa Edvin Rama, udhëheqësi aktual i Partisë Socialiste, e përpunoi dhe e zbatoi qysh në opozitë këtë teori, duke e milionerizuar tej çdo parashikimi dhe parimi përbërjen e strukturave të larta të kësaj force politike, me qëllim "blerjen" e pushtetit qëndror, duke shfrytëzuar këtu edhe eksperiencën e krijuar prej tij në pushtetin lokal. Dikush mund të thotë që po paragjykojë, por s'është aspak e vërtetë, pasi më poshtë do të shihni, që nëse se s'po argumentojë, po gjykojë drejtësisht dhe parimisht, jo vetëm sipas mendjes time.

Eliz Diaz, në "El Sol" të datës 26 prill 1991, rreth një muaj e gjysëm para se sa Partia e Punës të shndërrohej në Parti Socialiste, konsideronte si shenja të identitetit të së majtës, "një predispozicion

më të madh ndaj politikave ekonomike të rishpërndarjes e të nivelimit përpjestimor, të mbështetura më shumë te puna sesa te kapitali; më shumë vëmendje ndaj organizimit të çfarë është publike dhe e përbashkët, sesa ndaj çfarë është private dhe individuale; mbizotërimin të vlerave të bashkëpunimit dhe kooperimit ndaj vlerave të ballafaqimit e të konkurrencës; më shumë vëmendje ndaj lëvizjeve të reja shoqërore dhe kërkesave të tyre pacifiste, ekologjiste, feministe; preokupim për realizimin faktik të të drejtave të njeriut, sidomos në lidhje me grupet e emargjinuara; të moshuarit, fëmijët, etj.; këmbëngulje në përparësinë për të gjithë, të nevojave themelore të tilla, si shëndeti, shkolla, banesa; më shumë ndjeshmëri e dashamirësi ndërkombëtare për zonat e vërfëra, të varura e të deprimuara; mëvetësi e vullnetit të lirë dhe debatit të arsyeshëm, si në marrjen e vendimeve politike mazhoritare e demokratike, ashtu edhe për të sendërgjuar etika kritike e shndërrime, të cilat nuk imponohen me argumenta autoritare ose me dogma organizmash fetare të karakterizuara nga prestigji karizmatik dhe/ose tradicional".

Natyrisht, Fidel Yllit e Tom Doshit kanë ardhur në PS jo për të "shkrirë pasurinë e ta bëjnë..." parti, sipas këtyre parimeve të shenjta të së majtës, po për ta bërë partinë-pushtet me çdo kusht, në bazë të funksionit të parave të shtrenjta. Vendosmëria e kësaj iniciative majtiste duket edhe tek përpjekjet, gati një vjeçare të milionerëve socialistë, me protesta e greva urie për të ndryshuar rezultatin legjitim të zgjedhjeve parlamentare të 28 qershorit 2008, pavarësisht se një përpjekje e tillë maskohet me demagogjinë e transparencës së kutive. Që nuk është fjala për transparencë demokratike, po për tension

bolshevik, e tregon edhe "gjuha e forcës" së përdorur për ta përmbytur me dhunë pushtetin legjitim të mazhorancës aktuale. Disa fakte të zbuluara kohët e fundit tregojnë se ultimatimet e bëra nuk kanë qenë thjeshtë verbale, por militare. Jo shumë ditë më parë, u arrestua një anëtar i bandës së Zani Caushit, i dënuar në mungesë nga gjykata e rrethit Tiranë, në 2 shkurt të vitit të kaluar, i cili është kapur në krye të turmave protestuese të Edvin Ramës, duke kryer veprime aktive në bllokimin e rrugës tek "Ura e Farkës" në Tiranë e duke kundërshtuar punonjësit e Policisë së Shtetit. Ndërsa këto ditët e fundit u arrestua një tjetër militant-jomilinerë, por militarë i Partisë Socialiste, Arben Simoni, i cili në protestat e muajit maj të këtij viti, i vendosur në krye të një grupi militantësh rastës, të ardhur me autobus nga Lezha, ishte protagonist kryesor që vihej në krye të protestave të paligjshme, duke ushtruar dhunë ndaj qytetarëve dhe forcave të rendit në Bulevardin "Zogu i I" në afërsi të stacionit të Trenit në Tiranë. Ky peson, ndryshe nga lezhiani Gjovalin Kadelit, që "militantizimin" e tij ndaj kryetarit Rama e tregon me; 1 300 metër katror truall dhe një shtëpi private me sipërfaqe 154 metër katror në Tresh, 180 metër katror në Shëngjin, 74 metër katror apartament, 130,68 metër katror shtesë pallati, 54 metër katror një ndërtime tjetër, dy apartamente me sipërfaqe 233,1 metër katror dhe 132,3 metër katror, një restorant me sipërfaqe 180 metër katror në Shëngjin, 3 000 metër katror pyll dhe po kaq tokë, 704 metër katror truall, etj., ofron si mbështetje; 68 copë granata ofensive dhe defensiva, 86 kallëpe tritol me peshë 35 kg, 200 metër linear fitil zjarërpërcjellës, një automatik model 56, një mitraloz i rëndë, një pushke 20-ëshe, tre krehra fishekë model 56 të mbushur me fishekë, një shirit me 100 copë fishekë dhe një arke me 1250 copë fishekë, të mbështjella në thasë, që kishin emblemen e Partisë Socialiste. Siç shihet, grupi i "mitralierëve" shihet po kaq deçiziv për pushtetin e Ramës sa dhe ai i milionerëve, por që për shkak të realitetit politik në të cilin jetojmë, qëndrojnë gjithnjë në prapavijë. Në ballë janë milionerët, të cilët mbështesin pa hezitim të gjitha lëvizjet e Ramës që pas zgjedhjeve të fundit, duke përfshirë edhe zgjedhjet brenda PS-së në qendër dhe në bazë, të cilat pritet të formalizohen, këto ditë, në kongresin e socialistëve.

Por bazuar tek ajo që thonë kinezët se, "paraja mund të blejë një shtëpi, por jo një vatrë familjare; mund të blejë një shtrat, por jo ëndërrën; mund të blejë një orë, por jo kohën; mund të blejë një libër, por jo ndërgjegjen dhe diturinë; mund të blejë një post, por jo respektin; mund të blejë doktorin, por jo shëndetin; mund të blejë shpirtin por jo jetën; mund të blejë skesin, por jo dashurinë", shtojmë që, paraja mund të blejë gjithëçka, por jo Demokracinë. Dhe kjo, sepse, sipas Rusos, "nuk ka gjë më të dëmshme se sa ndikimi i interesave vetike mbi punët shoqërore", siç po ndodh në rastin e Ramës.



Sezoni turistik, fluks emigrantësh dhe turistësh të huaj në Kapshticë dhe Portin e Durrësit

Në mes të sezonit turistik pikat e kalimit kufitar të Shqipërisë janë të mbipopulluara me emigrantë dhe turistë nga vende të ndryshëm të botës, që vizitojnë vendin tonë.

Gjatë 24 orëve të fundit, përmes pikës kufitare të Kapshticës kanë hyrë në Shqipëri mbi 3500 persona dhe 1200 mjete.

Pala shqiptare dhe ajo greke ka punuar gjatë gjithë fundjavës

me 5 sportele. Ashtu siç paralajmërojnë dhe autoritetet e pikës doganore, në ditët në vijim pritet që fluksi të rritet, veçanërisht gjatë fundjavave të cilat janë më të favorshme për të udhëtuar.

Ndërsa në Portin e Durrësit dje kanë mbërritur 4 tragete me 4 150 pasagjerë dhe 856 automjete të nisura nga Porti i Barit. Prej pak ditësh në Portin e Durrësit ka nisur fluksi i mbërritjes në

atdhe të emigrantëve shqiptarë nga Italia. Si çdo vit bashkë atdhetarët tanë zgjedhin të kalojnë pushimet pranë familjeve të tyre. Në pikat e kalimit kufitar, vihet re gjithashtu një fluks në rritje i vizitorëve të thuaj, të cilët udhëtojnë drejt Shqipërisë për të eksploruar zonat turistike dhe mundësitë e arta që ofron vendi ynë për disa javë relaks dhe pushime të këndshme.

PS, politikë me dy standarde, fillimisht dënoi vendimin për rritjen e pagave, tani i kundërvihet edhe shkurtimit të shpenzimeve

Dy vendimet më të rëndësishme të qeverisë të javës së kaluar, për rritjen e pagave dhe pensioneve dhe shkurtimin e shpenzimeve, për t'i paraparirë efekteve të krizës ekonomike globale, janë kthyer në shënjestrën e axhendës ditore politike të opozitës shqiptare. Ish ministri i Financave Arben Malaj, u shpreh dje përmes një deklarate emocionale dhe pa fijen e logjikës, se qeveria nuk duhet të kishte marrë një vendim të tillë, në një kohë kur homologët e tij dënuan më herët rritjen e pagave dhe pensioneve.

“Një qeveri që shkurton me 9.5 përqind shpenzimet në total, por me 27 përqind investime nuk është vetëm se populiste. Kjo është masa më e keqe që mund të merret dhe pasojat negative për ekonominë do të ndihen vitet në vijim” - tha Malaj.

Malaj vëren se keqmenaxhimi i financave publike e ka zhytur ekonominë në një rreth vicioz ku njëra krizë ushqen tjetrën. Qëndrim ky jo vetëm i pabazë, por njëherazi një gënjeshtër e mirëfilltë, po të kemi parasysh se partia opozitare jo vetëm nuk ka marrë pjesë në asnjë prej vendimeve të mazhorancës për



shpëtimin e financave, por përkundrazi është munduar si kurrë ndonjëherë, t'i sulmojë ato dhe të përhapë panik.

“Ndërsa rritja ekonomike nuk do të jetë në nivelet që kishte parashikuar qeveria shpenzon në mënyrë jo efçente. Ka rritur borxhin, ka rritur deficitin dhe ka rritur edhe koston e parasë në ekonomi”, vijon më tej eksperti i opozitës.

Fakti që qeveria nuk arriti të marrë borxh në tregun ndërkombëtar, në një kohë që gjendja në ekonominë e eurozonës mbetet e paqartë, për ekspertin e opozitës parlajmëron kohë të vështira për ekonominë shqiptare. Por, faktet dhe të dhënat flasin të kundërtën. Ekonomia shqiptare po shkon drejt një ere të re zhvillimi, të cilën s'mund ta ndalojë as opozita dhe as Edi Rama.

LSI vlerëson koalicionin me PD-në

Unifikimi i programit qeverisës ndikoi në rritjen e pagave dhe përmirësimin e standardeve të integritimit

LSI vlerëson bashkëqeverisjen me PD gjatë këtij. Nënkrjetarja e LSI, Filloreta Kodra njëkohësisht zv/ministre e Punës u shpreh dje në një konferencë për mediat se me LSI në qeveri, programi është bërë dhe më social. “Koalicioni PD-LSI bëri të mundur që shumë prej synimeve sociale të programit të LSI-së, të jenë tashmë pjesë e programit qeverisës. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve tashmë realizohet nga struktura të veçanta institucionale përveç Ministrisë së Punës” u shpreh Kodra. Duke u ndalur në mbështetjen ndaj grave dhe krijimin e mundësive për punësim të tyre, nënkryetarja e LSI-së nënvizoi, se kjo ka qënë një nga prioritetet e programit të Lëvizjes Socialiste për Integritim. “Tashmë ka filluar puna për hartimin e akteve ligjore për nxitjen e bizneseve të grave dhe punësimin e tyre” - deklaroi ajo, duke shtuar se, me përparësi po punohet për të luftuar dhunën në familje. Kodra theksoi se, ka filluar puna edhe për rishikimin e Ndhmës Ekonomike për ta adresuar më mirë drejt shtresave në nevojë dhe për të rritur efikasitetin e këtij instrumenti kundër varfërisë.

Ndërkohë ajo bëri me dije planin e veprimit të miratuar nga qeveria, për mbështetjen e komunitetit rom.

Fëmijët

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve tashmë realizohet nga struktura të veçanta institucionale përveç Ministrisë së Punës. Miratimi i Projektligjit Kuadër për të Drejtat e Fëmijëve, bën të mundur punën sistematike për zhvillimin e fëmijëve dhe sidomos për eliminimin e punës së fëmijëve në Shqipëri

Gratë

Mbështetja e grave dhe krijimi i mundësive për punësim të tyre ka qënë një prej prioritetëve të programit të LSI, tashmë ka filluar puna për hartimin e akteve ligjore për nxitjen e bizneseve të grave dhe punësimin e tyre. Me përparësi po punohet për të luftuar dhunën në familje që vazhdon të marrë jetë njerëzish, është ngritur qendra e parë publike kombëtare për rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta prej majit 2010, në mënyrë sistematike mbledh dhe monitoron të dhëna mbi statusin e grave si një mjet për monitorimin e angazhimeve të qeverisë së Shqipërisë mbi barazinë gjinore dhe të drejtat njerëzore të grave.

Personat me aftësi të kufizuara

U miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1201, datë 03.12.2009 “Për miratimin në parim të Konventës së OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, që i hapi rrugën nënshkrimit të konventës së OKB, ratifikimi i kësaj konvente nga parlamenti shqiptar, që pritet nga fillimi i vitit 2011 i hap rrugën përmirësimit të kushteve të gjithë anshme dhe integritimin e kësaj kategorie në shoqërinë shqiptare. Ka filluar puna për rishikimin e Ndhmës Ekonomike për ta adresuar më mirë drejt shtresave më në nevojë dhe për të rritur efikasitetin e këtij instrumenti kundër varfërisë.

Pagat

Rritja e pagave si burim i mirëqenies së qytetarëve ka qënë dhe vazhdon të jetë prioritet i LSI dhe i qeverisë së koalicionit. Pagat e mjekëve rriten me 11 për qind; e infermierëve me 9 për qind; rrogat e mësuesve do të rriten me 6 për qind. Pagat e ushtarakëve nga 4 deri në 5.2 për qind. Pagat e ulëta rriten me 10 për qind

Pensionet

Të ardhurat totale mujore për pensionin e plotë minimal të pleqërisë llogariten jo më pak se 12840 lekë në muaj. Të ardhurat maksimale për pensionin e plotë të qytetit: nga 21052 lekë dhe bëhen 21880 lekë/muaj. Të ardhurat e pensionit të plotë të fshatit: ishte 7234 lekë dhe bëhet 7870 lekë /muaj. Të ardhurat e pensionit maksimal të fshatit: bëhen 10890 lekë muaj. Në këtë llogaritje nuk përfshihen ata pensionistë, të cilët përfitojnë kompensimin e energjisë prej 640L/muaj Projekt Ligjin “Për statusin e moshës së tretë”, nismë e LSI, është nisur për mendim në ministritë e linjës dhe bëhet gati për tu dërguar në Këshillin e Ministrave për miratim. Vazhdon puna për realizimin e marrëveshjeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore, përveç Turqisë, me të cilën është nënshkruar marrëveshja ka filluar negociimi me Belgjikën e Hungarinë

Loja me policë e hajdutë në degën socialiste të Tiranës

Redaksionale

Pas komisarit politik komunist, po ndërtohet komisarati politik socialist. Rikthimi i terminologjisë së vjetër në politikën e re dëfton se Partia Socialiste po përgatitet ashpër për zgjedhjet vendore të vitit të ardhshëm. Ashtu siç parashikohet, militarizimi i strukturave nëpër rrethe po menaxhohet nga dora e fortë e ish-Ministrit të fundit të Sigurimit, Gramoz Ruçi që është urdhëruar me qarkore të shtypë revoltën e bazës socialiste, e cila ka dalë kundër diktatit të edvinit për të pilotuar kryetarët socialistë të rretheve. Me afrimin e muajit elektorale dhe radikalizimin e pritshëm në vjeshtë, Edi Rama e ka ndarë mendjen të emërojë kryetarët e rinj të rretheve për partinë, që të këtë çdo gjë nën kontroll. Emërimi i ish-Kryepolicit të Tiranës, Pjerin Ndreu në kreu të degës së Partisë Socialiste në Tiranë është një sinjal i qartë se Edi Rama kërkon të ushtrijë një trysni fizike ndaj procesit zgjedhor në kryeqytet, ku shpreson ende të mbrojë kështu humbjen e mundshme. Me riprodhimin e strategjisë së 2007, ku u krijuan shtabet e policisë private dhe me politikanë në çdo mini-bashki, Edi Rama tregon se ka frikë për një dështim të mundshëm, prandaj po rikthehet skema e një dorë të fortë nëpër qendra votimi. Kështu që policia bashkiake e Tiranës, e përbërë nga 250 efektiva do t'u shtohet forca të tjera policore dhe politikanë për të tentuar një puç zgjedhor në Tiranë. Ndërtimi i një strukture paralele si policia zgjedhore (bashkiake dhe partiake) që ka ndërtuar Edvin Rama, në pritje fushatës dhe procesit elektorale, demaskon prirjen për të gjetur mburoja politike aferave miliona eurove që kanë multi-milionerët e PS-së me pretendim se po krijojnë "Komitetin të Shpëtimit të Votës".

Në krye të këtij Komiteti për Tiranën është vënë "Komisari i dritës", Pjerin Ndreu, Ish-drejtori i Policisë së Tiranës. Një polici që ka pasur gjithmonë tendenca politikë-bërjeje. Mbahen mend shkëmbimet dhe provokimet në vitin 2003 me Ministrin e Rendit, Igli Toska. Në atë kohë Pjerin Ndreu ishte edhe i shoqëruar në polici (dt. 18.09.2003) për t'u marrë në pyetje në lidhje me akuzën që është ngritur në adresë të tij, "kanosje për shkak të detyrës". Mësohet se Ndreu është prangosur, pasi u dyshua se ka kanosur një zyrtar të lartë të Ministrisë së Rendit Publik, emri i të cilit nuk u bë i ditur. Burimet e atëherëshme sqaruan se ky zyrtar ka denoncuar kanosjen prej ish-zv.drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ndreut, e më pas është vendosur shoqërimi i tij në polici. Ky arrestim erdhi në fund të një serie konfrontimesh që Ndreu kishte me strukturat e larta të Ministrisë.

Prej disa muajsh, kreu i Ministrisë së Rendit Publik dhe ish-zyrtari i lartë i kësaj ministrie, Ndreu kishte "shfrytëzuar" median për të shkëmbyer akuzat të rënda në adresë të njëri-tjetrit. Në muajin prill të vitit 2003, ministri i Rendit Publik, Igli Toska ka akuzuar ish-drejtorin e policisë së Tiranës, Pjerin Ndreu për skandalin e 350 pasaportave të lëshuara në mënyrë të jashtëligjshme në Gjirokastrë, për implikimin në një incident me armë, si dhe për shkelje të tjera të një natyre më pak të rëndësishme.

Shoku Pjerin Ndreu, shumë fjalë për asgjë

Shqipe Xoxi

Kryetari i ri i PS-së Tiranës, komisari i dritës socialiste Pjerin Ndreu është një nga ato personazhet që mbahet mend për çka thotë dhe jo për atë çka bën. Dhe këtë e ka vërtetuar sa herë. Në redaksitë e medie mbahet mend shumë mirë skup-i i tij në një të përditshme shqiptare për gjoja një shit-blerje deputetësh në merkaton e politikës shqiptare me shprehjen se "Dikush m'u afrua një ditë dhe më thotë që ti ke mik filan deputet. Po, i them. - A mund të bisedojmë me të, do jetë mirë dhe për ty nëse realizohet". Po mirë, ma thuaj si është puna, - i them. - Janë 2 milionë euro në dispozicion nëse ai pranon të ikë nga PS-ja. Ku të shkojë, - i them? - Po tek PD-ja, LSI-ja apo te grupi i kundërshtarëve të Ramës". Sigurisht akuzat të pavërtetuara sepse të pabazuara. Dhe natyrisht si ish-kryepolic i aftë do ta kishite denoncuar ndërmjetësin e kësaj oferte, por Pjerini që të gjithë e njohim thonë se Ai ka më shumë fjalë sesa vepra.

Sidoqoftë më parë Pjerini na kishte habitur në profesionalizimin e tij si opinionist kundër Ministrisë së Rendit Socialist, Igli Toska. Që në një shkrim të 26 maj 2004 shkruante shkrimin "Ministri Shtet" me fjalët "Që ky njeri (Igli Toska) që në çastin e ardhjes në karrigen e zv/ministrit e pastaj ministrit po abuzon hapur me të drejtën që i jep ligji kjo nuk ka as më të voglin dyshim. Por nuk kuptoj se si në këtë shtet nuk u gjend asnjë mekanizëm që të frenojë abuzimin skandaloz të pushtetit që po bën ministri aktual i rendit". Vërtet profesionale shkëmbimet e fyerjeve midis njerëzve me pozicione publike. Afërmendsh këto gjetje filipike Pjerini i bënte pasi ishte arrestuar për "kanosje" ndaj një kolegu, dhe një seri akuzash me Ministrin, Toska. Ky i fundit bëri publike (25/05/2004) akuzat të rënda ndaj ish drejtuesve të policisë. Pjerin Ndreu është akuzuar për vrasje të ngelur në tentativë, e shpërdorim tenderësh. Ilirjan Dida është akuzuar për kultivim të lëndëve narkotike e abuzime në tendarë. Bile Ministri ka shkuar deri aty sa "Ish Drejtori i Policisë së Tiranës, kryekomisar Pjerin Ndreu akuzohet për vrasje me dashje në bashkëpunim me një person tjetër, e ngelur në tentativë - thoshte ministri i Rendit Igli Toska gjatë një raportimi në Komisionin Parlamentar për Rendin dhe SHISH-in. Ministri deklaroi para komisionit se në Prokurori janë dërguar 4 kallëzime penale për ish drejtorin Ndreu, të cilat konsistojnë në: - "vrasje me dashje në lidhje

me një krim tjetër, në bashkëpunim, e mbetur në tentativë me nr.576 datë 21.04.2004. Për veprime arbitrare (ka penguar punonjësit e policisë në kryerjen e një detyre të ngarkuar më parë si dhe shoqërimin e tyre në ambientet e policisë me urdhër verbal arbitrar). Për shpërdorim detyre në tenderin e karburantit referuar me datën 16 prill 2004. Për shpërdorim detyre nëpërmjet dhënies së urdhrit të paligjshëm lidhur me shpenzimet në telefoninë fikse nr.357 date 05.03.2004. Material shtesë për çështjen e pasaportave të rifilluar nga Prokuroria e Gjirokastrës". Kështu njofton deklarata për shtyp e Ministrisë së Rendit në sajtin e saj: www.asp.gov.al/2004/prill/10njoftim.

Përsa i përket akuzës së parë që është shumë e rëndë dhe tregon për një tentativë të Pjerin Ndreut, kur ishte drejtor i Policisë së Tiranës, për të vrarë një person. Kjo ka të bëjë me një ngjarje të ndodhur në vitin 2003 në Tiranë. Ku Pjerin Ndreu në bashkëpunim me një person tjetër të njohur publikisht, kanë tentuar të vrasin Petrit Lleshin, i cili ka qenë person i kërkuar për vepra të tjera penale. Petrit Lleshit, policia e Tiranës në atë kohë i mveshi veprën penale të vrasjes së biznesmenit Florian Vila. Këtë version e rrëzoi Prokuroria. Ndërkohë që operacionin për arrestimin e Petrit Lleshit po e zhvillonin Forcat Speciale, në vendngjarje kanë shkuar Pjerin Ndreu dhe një person tjetër (Ish shefi i Krimeve të Tiranës gjatë 93-97) i cili nuk është më efektiv i policisë, dhe kanë qëlluar mbi të. Ndërsa akuzat e fundit ndaj Pjerin Ndreut që ka të bëjë me pasaportat në Gjirokastrë, është publikuar edhe më parë nga Ministria e Rendit, e cila pretendon se Ndreu ka pajisur me pasaporta njerëz të kërkuar për krime. Ndërsa dy akuzat e tjera që kanë të bëjnë me pengimin e punonjësve të policisë për të kryer detyrën dhe të shpërdorimit të detyrës në tenderin e karburantit në Drejtorinë e Policisë së Tiranës, janë akuzat që publikohen për herë të parë nga ana e Ministrisë së Rendit. Mirëpo këto akuzat ishin paraqitur nga policia gjyqësore pa prova. Çka detyroi Gjykatën e Tiranës (me datë 20. gusht 2004) të mos pranonte asnjë nga akuzat e policisë gjyqësore të Ministrisë së Rendit dhe të Prokurorisë lidhur me arrestimin e kryekomisarit Pjerin Ndreu. Gjykata e shkallës së parë të Tiranës mbi bazat e provave të paraqitura vendosi lirimin e Ndreut dhe vetëm paraqitjen e tij në policinë gjyqësore

35 mijë biznese shqiptare në Itali

Zef Bushati, numri 2 i diplomacisë shqiptare në Itali flet për prezencën në rritje të bizneseve shqiptare në fqinjin e fuqishëm, përtej Adriatikut

"Gjate takimeve me faktore të rendesishme të biznesit italian, tani kemi se çfare permendim; konkretisht duke filluar që nga sistemi bankar, nepermjet prezences se bankave italiane serioze e te forta e jo vetem ne Itali por edhe ne Europe si psh: "Intesa San Paolo", e deri tek "Banka Popullore Puglia e Basilicata", Banka Italiane e Zhvillimit... e po keshtu ne fushen e tregtise, nepermjet shoqerive te njohura e me emer ne Itali si Conad, Euronix, Ovieste, Coin, etj.e ne fushen e industrise, te shendetesise, arsimit, turizmit, bujqesise", thote Zef Bushati, sekretari i pare i ambasades tonë në Romë.

Kohët e fundit ne Shqiperi janë realizuar dhe po realizohen investime të mëdha. Por ajo që me ka befasuar dhe per te cilen po punoj me nje pasion te vecante eshte prezenca e bizneseve shqiptare ne Itali, thote Bushati. Nese me pyesni se çfare mund te veçoj si më të rendesishme ne marredheniet ekonomike mund te permend me mjaft kenaqesi e pse jo dhe me krenari, pikerisht faktin se simbas nje studimi te bere dhe statistikave me te fundit te nxjerra deri me 31 dhjetor 2009, sipërmarrësit shqiptarë në Itali, pra bizneset shqiptare ne Itali kapin shifren e 35 mije shoqerive. Jane 35 mije shoqeri shqiptare te regjistruara ne dhomat e tregetes italiane te cilat paguajne

rregullisht Partita IVA 20%, (Imposta sul Valore Aggiunto, ne shqip, TVSH,Tatim mbi vleren e Shtuar), si dhe çdo takse tjeter simbas ligjeve ne Itali. Shumica e ketyre shoqerive punojne në sektorin e ndërtimeve, por ka një prani të mirë në sektorin e bujqësisë, ne sektorin e mekanikes, restoranteve, tregëtise, transportit,etj. Nje shtytje simbas studimit te rritjes se numrit te bizneseve shqiptare ka dhene dhe bashkimi i familjeve. Shumë kanë zgjedhur për të hapur një zeje ose tregti të vogël me ndihmën e bashkëshortes ose te anëtarëve te tjerë të familjes, të cilët japin kontribut edhe si punonjës te shoqerise.Por mjaft prej shoqerive kane te punesuar edhe emigrantet te nacionaliteteteve te ndryshme. Nepermjet kesaj tablee do shihni dhe shperndarjen e ketyre shoqerive ne Rajonet e Italise ku numri me i madh ndodhet ne Rajonet me te zhvilluara si Lombardia,Toscana,etj.

Por per te patur nje evidence te te gjitha ketyre shoqerive, me emrin e shoqerise dhe te pronarit, do te duhej nje projekt dhe nje pune qe kerkon nje kohe relativisht te domosdoshme. Realizimi i kesaj evidence do te ndihmonte bashkpunimin midis Perfaqesise sone ne Itali dhe bizneseve shqiptare. Ekziston modeli dhe eksperiencia ne kete fushë e qe eshte pikerisht ne

Shqiperi ku biznesmenet italiane kane krijuar "Shoqaten e Sipërmarrësve Italianë në Shqipëri". Nje gje e ngjashme mund te jete edhe ne Itali ku shoqerite shqiptare mund te krijojin "Shoqaten e Sipërmarrësve Shqiptarë në Itali". Per kete ide po punohet e po bashkëpunohet me IOM, Organizata Nderkombetare per Imigracionin. Zyra e IOM-it ne bashkëpunim me ambasaden, simbas programit te prezantuar me pare, organizoi tryezat e rumbullakëta ne qytetin e Bari-t si dhe ne Rome ku u diskutua rreth projektit ne lidhje me: "Mundësitë dhe interesat e diasporës shqiptare në Itali për të investuar në Shqipëri". Ne takim per here te pare moren pjese dhe disa sipermarres shqiptare ne fusha te ndryshme te biznesit. Diskutimi ishte me shume interes. Aty u hodhen idete ne lidhje me mundesite dhe interesat e diaspores shqiptare ne Itali si dhe per organizimin e imprenditoreve shqiptare dhe rruget e bashkëpunimit. Nga pjesmarresit u evidentuan edhe potencialet qe gjenden ne komunitetin prej rreth 450 mije shqiptarësh ne Itali ku prej tyre 199,567 mije jane te gjinise femrore, ose 45,2 % e prezences se emigranteve.

Rajonet e Italise	Pronare	Bashk pronare	Admini stratore	Funksiione Te tjera	Gjithsejt	
ABRUZZO	723	59	154	4	940	
BASILICATA	17	1	2	2	22	
CALABRIA	53	6	16	1	76	
CAMPANIA	158	32	78	2	270	
EMILIA - ROMAGNA	4.256	238	829	25	5.348	
FRIULI - VENEZIA GIULIA	471	36	156	5	668	
FROSINONE	103	18	39	6	166	
LATINA	45	6	26	0	77	
RIETI	58	4	10	0	72	
LAZIO	ROMA	617	88	324	26	1.055
VITERBO	75	10	20	1	106	
TOTALE LAZIO	898	126	419	33	1.476	
LIGURIA	2.199	125	249	12	2.585	
LOMBARDIA	4.964	254	1.096	52	6.366	
MARCHE	1.129	217	172	4	1.522	
MOLISE	24	1	5	0	30	
PIEMONTE	2.961	271	624	37	3.893	
PUGLIA	471	44	134	4	653	
SARDEGNA	23	3	12	0	38	
SICILIA	130	10	39	7	186	
TOSCANA	5.378	362	653	31	6.424	
TRENTINO-ALTO ADIGE	487	81	121	2	691	
UMBRIA	746	141	117	4	1.008	
VALLE D'AOSTA	40	4	6	0	50	
VENETO	2.050	353	299	34	2.736	
TOTALE ITALIA	27.178	2.364	5.181	259	34.982	

Opinione të analistëve rreth përkeqësimit të marrëdhënieve Iran - Rusi

Nga Andre De Nesnera (VOA)

Rusia votoi për sanksione më të ashpra të OKB-së ndaj Iranit dhe ka pezulluar marrëveshjen për dërgimin e raketave kundër-ajërore për Iranin. Mendimi i përgjithshëm është që interesat ekonomike të Rusisë në Iran kanë bërë që Moska të jetë një partner i fuqishëm i Iranit, duke kundërshtuar forcimin e sanksioneve të OKB-së ndaj Teheranit për shkak të programit të tij të armëve bërthamore. Por shumë ekspertë, përfshirë John Parker i cili punon për Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare, thonë se marrëdhëniet mes Rusisë dhe Iranit po përkeqësohen. Ai thotë: "Marrëdhëniet Iran-Rusi ndoshta janë në pikën më të ulët që nga viti 1997 kur të dy vendet bashkëpunuan për përfundimin e luftës civile në Tashkikistan. Tani, tregëtia mes dy vendeve nuk është aq e madhe, fakt që shumë njerëz nuk e dinë. Tregëtia mes Iranit dhe Rusisë në pikën më të lartë arrin në 3,5 miliardë dollarë në vit. Dhe kjo nuk është më shumë se sa tregëtia e Rusisë me Izraelin, popullsia e të cilit është rreth 10 herë

më e vogël se popullsia e Iranit. Për shembull, Irani bënë më shumë tregëti me Turqinë dhe me Kinën se sa me Rusinë". Analistët si Robert Legvold i cili punon në universitetin e Kolumbias, thonë se gjatë viteve të fundit zyrtarët rusë janë bindur se Irani mund të jetë duke pasuruar uraniumin me qëllim që të ketë alternativën e prodhimit të armës bërthamore. "Në krahasim me Shtetet e Bashkuara ata nuk janë aq të alarmuar mbi nevojën urgjente për të reaguar kundër Iranit, por tani Moska ka rënë dakord me europianët dhe amerikanët se iranianët nuk po veprojnë në bazë të vullnetit të mirë për të treguar angazhimin për përdorimin paqësor të lëndës djegëse bërthamore, pavarësisht se cilat mund të jenë motivet e tjera të tyre. Dhe si rezultat, rusët janë të shqetësuar mbi çështjen e Iranit dhe sigurisht ata nuk duan që Irani të bëhet vend me armë bërthamore" - thotë ai.

Për të treguar pakënaqësinë e tyre ndaj Iranit, ekspertët thonë se Moska votoi në favor të rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për vendosjen

e sanksioneve më të fuqishme ndaj Teheranit, megjithëse teksti i rezolutës u zbut nga Rusia dhe Kina. Gaukhar Mukhatzhanova i cili punon në Qendrën e Studimeve për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore Monterey, thotë se zyrtarët rusë kanë arsye tjera të cilat i kanë shtyrë ata të binin dakord për sanksione të reja kundër Iranit. "Ata gjithashtu duan të sigurohen që Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli nuk do të ndjehen të detyruar të ndërmarrin veprime ushtarake. Unë mendoj se interesi kryesor i Rusisë tani është që nga njera anë t'i dërgojë një mesazh Iranit se ata nuk do ta mbështesin atë pa kushte, dhe nga ana tjetër, ata nuk duan të lejojnë veprime ushtarake kundër Iranit" - tha z.Mukhatzhanova. Ekspertët thonë se një shembull tjetër i përkeqësimit të marrëdhënieve mes Moskës dhe Teheranit është vendimi i Rusisë për pezullimin e vendimit për dërgimin e raketave kundërajrore S-300 që është pjesë e marrëveshjes së arritur në vitin 2007. Sa i përket uzinës bërthamore të Bushehrin në Iranin jupërendimor, zyrtarët rusë thonë se ajo do të fil-

lojë funksionimin brenda disa muajsh. David Kramer, ish zyrtar i lartë i Departamentit të Shtetit në administratën e presidenti George W. Bush, thotë se Moska gjithashtu ka bërë të njohur se uzina në Bushehr do të funksionojë si një ndërmarrje e përbashkët ruso-iraniane. Z. Kramer thotë: "Ky veprim tregon se Rusia nuk do të heqë dorë nga uzina bërthamore në Bushehr, megjithëse gjithashtu duhet patur parasysh se afati për përfundimin e saj është shtyrë disa herë. Kështu që nuk mund të përjashtohet mundësia që afati i hapjes së uzinës të shtyhet përsëri". Gaukhar Mukhatzhanova thotë se në bazë të veprimeve të fundit të rusëve, iranianët duhet të ndjehen të tradhëtuar nga Moska: "Po, unë jam i sigurtë se ata do të ndjehen kështu. Por Irani kurrë nuk i besuar Rusisë. Irani nuk i beson askujt. Kështu që ata veprojnë sikur të jenë tradhëtuar. Por, unë besoj se një pjesë e madhe e politikanëve në Iran në të vërtetë kurrë nuk janë mbështetur te Rusia". Analistët thonë se duke marr parasysh gjendjen dobët të marrëdhënieve mes Rusisë dhe

Iranit, ndikimi i Moskës mbi Teheranin është shumë i kufizuar kur është fjala për pakësimin e aspiratave të tyre për ndërtimin e armëve bërthamore. Robert Legvold nga Universiteti i Kalifornisë thotë: "Është ide e gabuar të thuhet se rusët kanë më shumë ndikim se sa të tjerët përfshirë Shtetet e Bashkuara mbi Iranin dhe programin e tij bërthamor. Nuk besoj se rusët kanë fuqi të madhe që do të ndikonte në qëndrimet e Iranit. Nëse Irani fillon t'i përgjigjet trysnisë së komunitetit ndërkombëtar, gjë për të cilën unë dyshoj, por nëse do ta bëjnë, atëherë fakti që Rusia do të ndihmonte në arritjen e kësaj, mund të kishte një farë rëndësie. Por, ndikimi i pavarur rus, të paktën nga pikëpamja për të qenë vendimtar, nuk mendoj se ekziston". Analistët thonë se është e vështirë të dihet se çfarë lloji trysnie mund të ushtrohet mbi Iranin për ta detyruar atë të heqë dorë nga programi i tij bërthamor. Ata thonë se sanksionet ndërkombëtare nuk mund të bëjnë gjithçka, veçanërisht kur dihet fakti se ende nuk ka mekanizma ndërkombëtare për zbatimin e sanksioneve.

Hezbollah po vuan konkurrencën e Turqisë në "rezistencën" ndaj Izraelit

Fokus

Vizita e kryeministrit Izraelit Benjamin Netanyahu në Uashington ka shërbyer me siguri në analizimin e situatës së krijuar në Lindjen e Mesme. Por ndër temat e diskutuara, të paktën duke lexuar kronikat që vijnë nga Shtetet e Bashkuara, haset se mungon një çështje thelbësore: Libani. Të nënvlerësosh ose, më keq akoma, duke mos e përfshirë në skenar Lindjen e Mesme do të ishte sikur të luaje shah pa pasur parasysh rolin e kalit. Pra e pakuptimtë. Sidomos në një kohë kur po ndodhin trazira të mëdha në Bejrut dhe rrethinat e saj, siç dëshmohej nga incidenti i rëndë i ndodhur në jug gjatë një stërvitjeje të misionin të paqes së OKB-së "UNIFIL". Por ka shumë tregues të cilat sinjalizojnë shkallën e lartë të nervozizmi në radhët e Hezbollahut, (ashtuquajtur partia e zotit në Liban).

Rasti i flotës pseudo-pacifiste me flamur turk, e cila u përpoq të thyente embargon izraelite kundër Rripin e Gazës, në fakt, do të përbente një kërcënim serioz të mundshëm për Partinë e All-Illahut, pra ta asaj që është parakaluar nga Turqia, si një mbrojtëse e "kauzës" së Palestinës. Ndërsa në Perëndim, ka një tendencë për të nxjerrë në pah thjesht përplasjen midis Ankarasë dhe

Jerusalem, në anë të Bejrutit kjo çështje është parë nga një perspektivë tjetër, pra si një betejë për dominim rajonal midis Turqisë dhe Iranit, pra mes e shi'itëve dhe sunitëve. Në vitet e fundit, terroristët e Hamas-it (sunitë) e kanë pranuar ndihmën që u vinte nga Irani (shi'itë), sipas argumentit të vjetër realist se "armiku i armikut tim është miku im". Për një kohë të gjatë dallimet - megjithatë të thella - mes forcave në terren (Hamas, Hezbollah, dhe Rojeve Revolucionare iraniane), ishin lënë mënjanë, ishin lënë në hije nga një zam shumë më i fortë: urrejtja anti-izraelite. Por tani skenari mund të ndryshojë, sepse, për herë të parë roli i Mubarakut (president i Egjiptit, i cili thuhet se është me kancer) ka filluar të tjetërsohet, dhe një vend i rëndësishëm mysliman sunit si Turqia mund të shkojë dalëngadalë të marrë këtë vend në zemrat e palestinezëve, e mandej edhe pjesën e që mbahet nga Irani dhe Hezbollahut.

Dhe është më se logjike, atëherë, që milicia libaneze shi'ite të mos e shohë me sy të mirë një



perspektivë të tillë, dhe janë të detyruar të ndërmarrin vepra më të rrezikshme për t'ju treguar palestinezëve se janë ata që i duan më shumë. Frustrimi është i madh për shkak se në sytë e palestinezë "për Gazës ka bërë më shumë Turqia me një flotë prej aktivistësh, sesa 10.000 raketa të lëshuar nga

Hezbollahu", - sipas deklaratës të bërë nga Aziz Dueik, një udhëheqës i Hamasit në Uest Bank. Siç është cekur edhe në një shkrim Michael Young në gazetën e rëndësishme libaneze "Daily Star", "kjo do të thotë në praktikë se turqit kanë shumë për të thënë në çështjet e luftës dhe paqes në rajon, dhe se tani e tutje, Turqia do të shqyrtojë me kujdes implikimet dhe veprimet e Iranit, Sirisë dhe Libanit që mund të kenë mbi interesat kombëtare, çka do të thoshte kufizime në autonominë Hezbollahut dhe jo vetëm të saj, duke e zvogëluar kështu rolin që kanë pasur deri tani kundër Izraelit".

Përveç kësaj, nuk ka kaluar pa u vënë re nga Sekretari i Përgjithshëm i Hezbollahut, Hassan Nasrallah, entuziazmi i shpërthyer në Bejrut për ngjarjet e flotës kinse pacifiste, për shkak se amplifikimi i ngjarjes me një anije të flotës turke erdhën nga vetë kryeministrit Hariri i Saad dhe Ualid Jumblatt, për të cilët është

më mirë të rrisin mirëkuptimin me Ankaranë dhe të dobësojë rolin ndërhyrës të Iranit dhe përfaqësuesit të saj në Liban. Loja turke ka dobësuar për këtë arsye Partinë e All-Illahut, dhe jo vetëm nga jashtë, ndaj akuzës palestinezë, por edhe brenda ku rrezikon të humbasë skeeptrin e rezistencës. Për këtë arsye Hezbollahut - pas ngjarjeve të anijes së Paqes lajmëroi dërgimin e një ekspedite tjetër me autorësi Shite, e cila do të lundroi nga portet e saj në Liban, e që është tani pio përshkon rrugën për në Gaza, dhe për këtë nisje është marrë nën në shënjestër misioni i paqes së OKB-së "UNIFIL" për të zhvendosur vëmendjen, sepse Turqia ende ka një kontingjent forcash në kuadër të OKB-së të stacionuara në Liban, dhe atëherë duke diskredituar UNIFIL-in Nasrallah do të dëmtojë rolin që ka qeveria Turke në rajonin.


Gjithsesi ndofta është shpejt për të thënë se jemi me të vërtetë në fillim të një tërmeti që do të çojë në një ri-ekuilibër forcash ndikimi në Lindjen e Mesme, por sinjalet që vijnë të shtyjnë në këtë drejtim. Mbetet të shihet nëse Perëndimi dhe Izraeli, kjo do të barazohet me rënien nga tigani në zjarr, apo në qoftë se Turqia do të marrim një fakt më të moderuar dhe të prirur për dialog se sa Irani, Siria dhe Hezbollahu.

Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

Komploti kundër Kishës

Shtëpia Botuese 55 sjell për lexuesin një nga librat me te debatuar mbi historinë e Kishes Katolike



Ky libër, historikisht i rëndësishëm, do të sulmohet, me të gjitha mundësitë, si antisemitik. Librin rrefen se, hebrenjtë kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm, dhe, jo gjithnjë të dobishëm, në të gjithë historinë e njerëzimit e kjo është e dukshme; që veprimtaria e tyre nuk ka qenë gjithnjë miqësore kundrejt Krishtërit dhe popujve johebrenj, është, gjithashtu, e dukshme, dhe ka një fond të jashtëzakonshëm evidencash nga burime judaike e të tjera, të autoritetit të palëkundur, që e provon këtë



Linja Direkte, është ideuar dhe realizuar, duke pasur si objektiv të saj kryesor, transparencën dhe luftën antikorrupsion

Denoncimi i korrupsionit dhe zvarritjeve ZQRPP/ ja ku dhe si mund të denonconi

Sot pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP), fillon shërbimi i numrit jeshil "Linja Direkte"

"Linja Direkte", është ideuar dhe realizuar, duke pasur si objektiv të saj kryesor, transparencën dhe luftën antikorrupsion. Në funksion të këtij objekti, kjo linjë, do të sigurojë mundësinë për publikun në depozitimin e mesazheve dhe ankesave të mundshme të tij për vonesa dhe shërbime të papërshtatshme, apo edhe për denoncime të praktikave korruptive, të përpunojë e vlerësojë informacionin, të adresojë për zgjidhje, në bazë të ligjeve dhe rregullave të gjitha çështjet, si dhe të vendosë një komunikim efikas dhe të ndërsjellët me publikun. Për të gjitha këto, të cilat qëllimin kryesor kanë një komunikim efikas dhe të ndërsjellët me publikun, në përputhje me përmbushjen e rregullave dhe përmbajtjen e etikës, "Linja Direkte", mundëson një komunikim me publikun, nëpërmjet: Mesazheve zanorë në numrin e telefonit të ZQRPP-së, ++ 355(0)(4)2403305; SMS-ve në numrin mobile (celular) ++ 355 (0) 67 20 20 234 të vënë në dispozicion për publikun nga ZRPP-ja; E-mail në adresën elektronike e-mail: ankesa@zrpp.gov.al; Regjistrimin e mesazheve në faqen zyrtare të internetit të ZRPP-së, www.zrpp.gov.al. Në funksion të përmbushjes së objektivit të saj kryesor, nëpërmjet shërbimit "Linja Direkte", ZQRPP-ja, do të pranojë ankesa dhe mesazhe nga komunikimi me publikun, që përmbajnë këto informacione që quhen të vlefshme: Subjektin e mesazhit, apo të ankesës; emrin e personit; numrin e telefonit; adresën e-mail (në se ka); adresën e saktë të ban-



Në përmbushje të objektivit të tij kryesor, si edhe në funksion të ndërtimit të marrëdhënieve sa më të drejtë për drejtë me publikun, projekti "Linja Direkte", parashikon dhe realizon një cikël të mbyllur të mesazheve dhe ankesave që mbërrin nga publiku

imit; tekstin e mesazhit, apo të ankesës. Nga ana tjetër, "Linja Direkte", do të jetë një ndihmë edhe për vetë ZQRPP-në, për të adresuar dhe evidentuar problemet mundshme të saj. Që ky proces, të jetë sa më efikas, është parashikuar dhe përgatitur "Fushata dhe Strategjia e Informimit Publik për 'Linja Direkte'", e cila midis të tjerave do të mundësojë: përcaktimin e problemeve ekzistuese; planifikimin dhe programimin; marrjen e masave dhe Komunikimin; vlerësimin e Programit të Komunikimit. Në përmbushje të

objektivit të tij kryesor, si edhe në funksion të ndërtimit të marrëdhënieve sa më të drejtë për drejtë me publikun, projekti "Linja Direkte", parashikon dhe realizon një cikël të mbyllur të mesazheve dhe ankesave që mbërrin nga publiku. Projekti, nëpërmjet këtij sistemi, parashikon dhe mundëson, "depozitimin", "vlerësimin", "përpunimin", "bashkëpunimin", "zgjidhjen e problemit", "kthimin e përgjigjes", si edhe "mbylljen me sukses", të mesazheve dhe ankesave të mundshme të mbërritura.

TELEFONAT DHE ADRESAT E E-MALIT KU MUND TË DENONCONI

- Mesazheve zanorë në numrin e telefonit të ZQRPP-së, ++ 355 (0) (4) 2403305;
- SMS-ve në numrin mobile (celular) ++ 355 (0) 67 20 20 234 të vënë në dispozicion për publikun nga ZRPP-ja;
- E-mail në adresën elektronike e-mail: ankesa@zrpp.gov.al;
- Regjistrimin e mesazheve në faqen zyrtare të internetit të ZRPP-së, www.zrpp.gov.al

KUR SUBJEKTI I MESAZHIT TË ANKESËS QUHET E VLEFESHME

- Emrin e personit;
- Numrin e telefonit;
- Adresën e-mail (në se ka);
- Adresën e saktë të banimit;
- Tekstin e mesazhit, apo të ankesës.



INTERVISTE/ Flet Ing. Arqile Gorea, Drejtor i Përgjithshëm i Postave të Shqipërisë:

“E vështirë është vetëm të mendosh në nuk realizohet”

Z. Gorea, nga data 1 korrik e këtij viti, pra para pak ditësh, të 520 mijë pensionistët e vendit tonë po marrin një pension të rritur me 4-10 përqind. Ju a ju shërbyet këtyre pensionistëve?

Nuk është hera e parë që Posta Shqiptare ballafaqohet me të tilla detyra të ngarkuara nga qeveria shqiptare, nga bashkëpunimi me Institutin e Sigurimeve. Mund të them që edhe këtë herë Posta Shqiptare jo vetëm që ishte tërësisht e përgatitur, por ka pasur edhe një bashkëpunim shumë të mirë me Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Pra, më datën 1 korrik, pikërisht në datën e caktuar nga qeveria shqiptare, ne filluam shpërndarjen e pensioneve nëpër shtëpitë e pensionistëve me kuotat e reja të përfituara. Madje që ditën e parë 15 mijë pensionistë nga këta 520 mijë që ju përmendët morën pensionin e ri të caktuar nga qeveria shqiptare.

Nuk pati abuzim nga ana e postierëve, ngasje për t'i dhënë pensionistit shifrën e mëparshme, pa shtesën?

Jo. Nuk kemi regjistruar asnjë rast ankese të pensionistëve. Janë sot rreth 150 mijë pensionistë që e marrin pensionin në shtëpi nga Posta Shqiptare. Zyrat tona ishin të përgatitura. Nuk pati një ngutje, një dyndje të pensionistëve në to, me atë frikën ose tensionin se mund ta humbnin, mund të mos e marrin shtesën. Ky është një tregues që njerëzit kanë filluar të besojnë tek Posta Shqiptare dhe tek qeveria shqiptare, në vendimet që ajo merr. Sepse këto janë realitete.

Pati radhë të gjata, pritje të këtyre njerëzve të moshuar në këto ditë të ngrohta?

Gjithshka ka shkuar në normalitet. Për shembull, sot që po bisedojmë bashkë, ka shkuar në rreth pesëdhjetë e ca mijë numri i pensionistëve përfutues. Natyrisht ata paraqiten sipas datave të përcaktuara në kalendarin e përfutimit të pensionit. Do të doja t'ju garantoja se gjithshka shkon normalisht. Kjo është një shenjë e civilizimit, e emancipimit jo vetëm të klientit, por edhe e shërbimeve që ne ofrojmë për të.

Pa radhë të gjata, që të kujtojnë një kohë tjetër...?

Jo, besoj se Posta Shqiptare sot paraqitet me të tjera realitete.

Keni marrë përsipër edhe një detyrë të vështirë, shërbimin ndaj qytetarëve për pagesën e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike. Nuk është e lehtë të përballosh një fluks prej qindra mijëra qytetarësh...

Kjo është një detyrë e ngarkuar nga qeveria shqiptare. Në kuadrin e programit që kjo qeveri ka për integrimin e vendit drejt familjes së madhe europiane, pra drejt trashëgimisë historike të kombit tonë, Posta Shqiptare është një pjesë e strukturës së përgatitur nga qeveria shqiptare për integrim. Pra, ne morëm detyrën për të shpërndarë kuponat e pajisjes me karta identiteti dhe pasaporta biometrike. Të them të drejtën, është e paimagjinueshme edhe për ndërkombëtarët që na kanë vizituar, që shqiptarët në më pak se një vit -më 12 shkurt 2011 besoj mbushet viti- po arrijnë në 2 milion karta identiteti dhe 1 milion pasaporta biometrike.

Nuk ka pasur konfuzion në zyrat tuaja, dyndje qytetarësh, vështirësi informacioni, qytetarë që nuk dinin ku të paguanin?

Ka patur probleme, por jo esenciale. Problemet kanë qenë në akumulimin e eksperiencës në ato fillime, ose në formulën e dizinformacion-



eve, që nuk kanë qenë të pakta. Por vetë shifrat që janë realizuar në këto kuota tregojnë një dëshirë të pakontestueshme të qytetarëve shqiptarë për të shkuar drejt familjes së madhe evropiane.

Ka pasur raste abuzimi nga sportelistë tuaj? Raste kur qytetarëve u tregohet një shifër e fryrë për pagesën?

Mendoj se tolerancat e Postës janë në dimensionet konsiderueshme. Në rast se mund të ketë një rast të vetëm abuzimi tek një pensionist, kur janë 520 mijë, kjo nuk mund të quhet rast tipik. Dhe në 2 milion vetë të furnizuar me kuponat për kartat e identitetit ose ndër ata një milion të furnizuar me kupona për kartat biometrike mund të ketë pasur raste, por këto në 90 përqind të tyre kanë qenë të simuluar nga njerëz të motivuar ndryshe. Jo të gjithëve u vjen për mirë e mira. Varet nga klima që është mësuar të jetojë njeriu.

Mendoni se kanë qenë dashakeqës ata që janë ankuar, e kanë parë me syze të errta Postën dhe shërbimin e saj?

Të kërkojë të ngrish vetë, për t'i bërë të tjerët të dridhen, kjo mendoj se është veti e dashakeqësit. Nuk është e atij që dëshiron progresin.

Në faqen tuaj në internet, keni përmendur që është realizuar diçka e madhe me Kodin Postar të vendit. Pse është vonuar kaq shumë ky Kod?

Kodi Postar nuk është vonuar, ka qenë detyrë e kryer që në vitin e parë të qeverisjes sonë. Sipas porosisë që morëm nga Kryeministri, në ditën e paraqitjes së Dokumentit tonë numër një të zhvillimit-duhet ta dimë që Posta ka një specifikë: gjatë gjithë kohës ne kemi ecur, jemi orientuar dhe kemi përcaktuar piketat vetëm në bazë të projekteve. Gjithshka e bërë është parathënë më parë në planet tona. Hapi ynë i parë ka qenë kthimi në identitetin e Postës Shqiptare. Në atë ceremonin na nderoi me pjesëmarrjen e tij kryetari i qeverisë dhe një nga porositë e para që na ka dhënë ka qenë që vendi të bëhet me Kod Postar. Ne, në muajin e parë, në ditën ndërkombëtare të Postave në tetor 2006 kemi lançuar Kodin Postar.

Po atëherë pse në gjithë këto vite pas tetorit 2006 përherë ka pasur probleme me gjatjen e adresës së saktë të qytetarëve?

Është tjetër gjë Kodi Postar, tjetër adresa. Adresa është një pjesë e integruar në Kodin Postar. Ne e përfunduam tërësisht Kodin Postar në atë kohë që po ju tregoj. Do të thoja se ka qenë një kod cilësor, i vlerësuar edhe nga Organizata Ndërkombëtare e Postave. Nuk e tregoj ta them se është marrë edhe për shembull.

Por ai tek e fundit është thjesht një dokument, letër. Si po zbatohet ai?

Ne kemi përgatitur edhe Manualin e Përdorimit të Kodit Postar. Por ka patur disa probleme. Për shembull, një Zyrë Postare, që përfshihet në një shifër të caktuar të Kodit Postar, ka kufizimet e veta të aktivitetit. Por këto kufizime, që ne i kishim përcaktuar si rrugë. Por kishte edhe rrugë pa emra.

... Më datën 1 korrik, pikërisht në datën e caktuar nga qeveria shqiptare, ne filluam shpërndarjen e pensioneve nëpër shtëpitë e pensionistëve me kuotat e reja të përfituara. Madje që ditën e parë 15 mijë pensionistë nga këta 520 mijë që ju përmendët morën pensionin e ri të caktuar nga qeveria shqiptare...

Nuk i takonte zyrës suaj t'i vendoste emrat?

Ka qenë një mospërputhje që kemi pasur në progresin tonë me pushtetin lokal, bashkitë dhe komunat. Kjo gjë tani është në rrugë të mbarë dhe shumë shpejt shqiptarët do të kenë funksionalitetin e Kodit Postar. Mendoj se qeveria është e angazhuar në një iniciativë serioze, së bashku me Ministrinë e Brendshme dhe të Pushtetit Lokal, për t'i bërë shqiptarët me adresa të sakta, të cilat do të jenë pjesë e integruar e këtij Kodi Postar. Dhe shpresoj që me përfundimin e këtij detaji, përdorimit të Kodit, vendi ynë do të jetë një shembull për ato vende që ende nuk e kanë këtë kod.

Ju jeni qytetar i këtij vendi, zoti Gorea dhe e dini mirë imazhin e shëmtuar që Posta Shqiptare kishte marrë vetëm deri pak vite më parë, me njerëz të saj që në fshehtësi hapnin pakot e qytetarëve, të sjella nga emigrantët apo të njohurit e tyre nga jashtë. Mund të quhet ky imazh i dalë mode një herë e përgjithmonë?

Mendoj jo thjesht imazhi, por më të gjitha ka ndryshuar edhe funksioni, ka ndryshuar edhe motivi. Nëse një punonjës Poste dikur, pa përmendur vite, e shikonte klientin si viktimë, ne punojmë me lajtmotivin që klienti është mbret. E kam thënë edhe herë të tjera, e kam përsëritur dhe do ta stërpërsëris. Ky do të jetë lajtmotivi i Postës Shqiptare. Sepse është funksioni i ekonomisë së tregut. Ai që paguan është mbreti. Dhe mbretit i falen të gjitha. Dhe e dyta, që në historinë e lindjes së shërbimit postar, Posta ka qenë dhe mbetet amanet. Motivi jonë ka qenë ky: kush luan me amanetin, luan me vendin e punës.

Janë larguar njerëz që kanë dashur ta luajnë këtë lojë...?

Po të them se masa e largimit mund të jetë e frikshme. Mbi 300 vetë janë larguar.

Po ju keni punësuar ndërkohë gati dyfishin e punonjësve të mëparshëm?

Punonjës të rinj Posta Shqiptare ka 1030 vetë.

Janë këta të justifikuar me punë, me vendet e punës?

Ne kemi prishur mentalitete, për të ndërtuar kualitete të reja. Nuk mund të krenohem dhe të them që kualitetet e reja janë të këtij apo atij niveli. Beteja jonë e vazhdueshme, çdo orë, çdo ditë, çdo javë, çdo muaj dhe çdo vit do të jetë beteja për përmirësimin e mentalitetit dhe kualiteteve njerëzore. Kjo do të jetë ajo që do ta bëjë Postën Shqiptare jo vetëm me pamje vizuale, por dhe me funksionet, me kualitetet e shërbimit të nivelit evropian.

Ju keni investuar ndjeshëm dhe sot keni një flotë automjetesh, një Pikë Tranziti që ju lejon t'u shërbeni më mirë qytetarëve. A i është i mjaftueshëm ky investim?

Në situatën që jemi, flota jonë erdhi natyrisht. Jo vetëm në anën sasiore, por edhe në atë cilësore. Sot automjetet e Postës Shqiptare të gjithë qytetarët i shikojnë në çdo skaj të vendit, me kualitetet jo vetëm teknike, por edhe vizuale dhe funksionale. Jua përmenda përpara dy porositë që Z. Berisha na dha në promovimin e Dokumentit Numër Një të Zhvillimit, i cili kishte për qëllim kthimin e Postës Shqiptare në normalitet. Pra, nga një godinë e braktisur, në një shtëpi të banuar për nevojat e qytetarëve. Porosia e dytë ishte që të shpërndajmë shtypin, ta çojmë shtypin edhe në zonat rurale. Duke mos i privuar këto zona nga informacioni. Dhe ne e kemi bërë këtë realitet.

Mos janë porosi shumë të kushtueshme? Keni marrë para subvencion nga Buxheti i Shtetit për këto?

Përkundrazi. Ne jemi Sh.A, shoqëri aksionere, nuk marrim subvencione. Por me flotën tonë të automjeteve ne kemi një reklamë jash-tëzakonisht të fuqishme, lëvizëse. Jo një reklamë që varet se ku e çon telekomandën qytetari, siç ndodh me televizionet, por një reklamë që shkon tek qytetari kudo që të jetë. Në çdo skaj të Shqipërisë qytetarët shohin makinat e Postës Shqiptare. Shohin shtetin që është pranë tyre, mundësinë për të kryer nevojat që kanë nëpërmjet kësaj strukture gjithmonë e më pranë tyre. Ne kemi arritur në çdo skaj të vendit. Nga 37 pika që kemi patur, jemi në mbi 130 pika.

Nuk ju kushton mbajtja e këtyre 130 pikave? Është një rrjet i tërë.



Të tëra janë kostoze. Por të tëra janë dhe refraktare. Pse? Se edhe fshatari e kupton se po nuk hodhi një thes me farë në arë, nuk do të shkojë dot për të korrur. Nga hiçi asgjë nuk mbin. Ne investojmë dhe korrim.

Ku i gjeni paratë që investoni?

Po ju jap një rezultat shumë të thjeshtë, nga pesë milion objekte postare (letra, pako, porosi, shërbesa, etj.) që kishim në vitin 2005, në vitin 2009 arritëm rreth 20 milion objekte postare. Ky është realiteti ynë. Në një kohë kur në botë u tha se shërbimi postar po shkon drejt dekadencës, kur të gjitha postat patën me të vërtetë hemorragji, Posta Shqiptare u katërfishua.

U rritët edhe në pikun e krizës, në vitin 2009?

Po. Kjo ndodhi pse Posta Shqiptare përdori metoda universale jo vetëm të shfrytëzimit të resurseve ekzistuese, por punoi në mbjelljen e mentaliteteve dhe në promovimin e shërbimeve të reja. Sepse edhe shërbimet elektronike mund të bashkëjetojnë shumë mirë, në simbiozë me shërbimin postar. Po ju jap një shembull. Deri dje kishim telegramet, një shërbim klasik. Tani është mesazhi në SMS. Thuhet nga shumë njerëz se SMS-ja ia humbi vlerën telegramit. Por atëherë, në raportet dhe marrëdhëniet që ka qytetari me Shtetin, a ka nevojë për letra? Ka. Një lajmthirrje, një dokument. Ne po përgatitemi për shërbimet "E-Government". Do të shpërndajmë internetin në të gjithë Shqipërinë, deri në fund të vitit.

Po si mund ta kryeni, është një kosto e jashtëzakonshme, një strukturë më vete?

Duhet të kuptojmë një gjë, funksionin e Postës Shqiptare. Ajo nuk është ndërmarrje buxhetore. Është një Sh.A që punon, krijon dhe shpenzon kontributet e veta, përpos detyrimeve që ka dhe derdh në arkën e Shtetit në të gjitha format e taksave dhe tatimeve, sikurse i derdhin edhe subjektet e tjera.

Aq më tepër e keni të vështirë të gjeni fonde...

Një terren malor mund të jetë i vështirë, por një terren malor është i vështirë për një trup të dobët. Jo për një trup të shëndoshë. Lodhja dikujt i jep stres, dikujt kënaqësi, e quan fizikulturë. Pra, jo të gjitha gjërat duhen parë në një këndvështrim të vetëm. Në vitin 2009 ne mundëm të kemi një fitim 13 përqind më të lartë se sa ai i planifikuari.

Në pikun e krizës?

Po. Makinaria e Postës Shqiptare u kolaudua edhe në momentet më të vështira. Tregoi që punon me efikasitet dhe realizon objektivat që ka.

Si arritët, njerëzit u drejtuan më shumë Postës?

Jo. Ne shfrytëzojmë nevojat e qytetarëve, tregun aktual.

Sa pjesë të tregut mbani sot?

Rreth 70 përqind të tij.

Por nuk ka qenë kaq. Si arritët të kapni këtë treg?

Jua thashë, në strategjinë tonë të zhvillimit, faza e parë e projektit ishte ta kthejmë Postën Shqiptare në një banesë të të gjitha nevojave të shqiptarëve.

Ju subvencionoi Shteti?

Absolutisht jo. Gjithshka është kontribut i punës së stafit të Postës. Dua të them se ndihma më e madhe i takon Kryeministrit Sali Berisha, i cili që në momentet e para e ka kuptuar dhe mbështetur Postën.

Por ai nuk ju dha para. Si ju ndihmoi?

Ajo lloj ndihmë që dha është shumë e madhe, është karburant i zhvillimit. Të pasurit mbështetje, të krijuarit të një klime të favorshme zhvillimi mendoj se është aspirata e çdo biznesi. Klima e biznesit është parësore. Një lloj si

bima që ka nevojë të çelë në një ambient të caktuar: temperatura, lagështia, formacioni i tokës. Ne kemi pasur një klimë shumë të favorshme në këtë drejtim. Jo duke prishur rregullat e lojës. Ne konkurrojmë si të gjithë të tjerët. Por kemi patur një mbështetje. Posta Shqiptare duhet të jetë partnere e qeverisë për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian dhe për plotësimin e nevojave. Posta është një makineri ekonomike që nuk ka firo rrugës. Është e projektuar mirë, me parametra bashkëkohore dhe do të japë se s'bën rezultate. Ne nuk vumë një ventilator sipër një ene që zien, për të shfrytëzuar energjinë e avullit. Por kur shfrytëzohen të gjitha resurset, të gjitha potencialet që ka një kompani, unë mendoj se jo vetëm për Postën Shqiptare, por mundësia në Shqipëri është për të gjitha kompanitë që të mund të jenë të suksesshme. Boll që t'i nënshtrohen një analize. Ku çdo biznes përcakton pikat e forta dhe të dobta që ka. Natyrisht, stimulon pikat e fuqishme dhe përmirëson të dobta.

Por më lejoni, është e vështirë zoti Gorea, pse ju keni ndryshuar çdo pikë apo zyrë postare në vend, që të investosh në një sistem



kaq të gjerë. Është e vështirë edhe të fitosh besimin e njerëzve, edhe të dalësh me fitim të rritur...

Jo, absolutisht. I tërë investimi është kontribut i produkteve që ka dhënë makinaria e Postës Shqiptare. Gjithshka që preket për mirë, është e lehtë. E vështirë është vetëm të mendosh që nuk realizohet. Unë jam inxhinier dhe gjithnjë mendoj: po të mos kishte hendeqe, do të shpikeshin urat? Por të mos kishte detra, do të shpikeshin anijet? Gjithmonë përpara shoqërisë kanë dalë vështirësi dhe vështirësitë kanë detyruar njerëzit që të gjejnë mënyra për t'i kapërcyer ato. Ne kemi ecur me projekte dhe projektet tona kanë konsistuar gjithmonë në zgjidhjen e vështirësive. Duke u përpjekur t'i zgjidhim në mënyrë sa më racionale.

Të gjitha postat moderne sot në botë funksionojnë edhe si bankë. Ministri ynë i Financave ka besim në të mirat e një shërbimi të tillë. Ju do ta kërkonin këtë shërbim? Jeni në gjendje ta mbani?

Do të thoja se Posta Shqiptare është e vetmja postë që nuk e ka Banko-Postën. Kështu që kjo është një detyrë imediate dhe e kohës. **Ka dhe një urdhër të Kryeministrit mbi ngritjen e një grupi pune për studimin e kësaj mundësie. Ky grup pune kryesohet nga ministri Pollo dhe është duke punuar. Është bërë një draft. Është duke u konsultuar me të gjitha grupet e interesit.** Është duke u parë edhe me normat e Bashkimit Evropian. Mendoj që kjo është një iniciativë e vonuar e jona.

Ju keni pare BankoPosta në botë se si funksionojnë?

Po. Shumë vende të botës kanë zgjedhur praktika të ndryshme, në bazë të kushteve të tyre specifike. Ne kemi vizituar posta dhe banko-posta si në vendet Evropianolindore dhe në ato Perëndimore, nga më të zhvilluarat. Mendoj se është një simbiozë funksionale bashkëzistenca e postës me banko-postën.

Çfarë të rehash do t'i sillte ky shërbim i ri tregut tonë bankar, çfarë vlerë të shtuar?

Ne të gjithë jemi dëshmitarë që shtrirja e sotme e bankave nuk është në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ende rreth 50 përqind e territorit nuk është i mbuluar nga shërbimi bankar.

Dihet që drejt Bashkimit Evropian qeveria jonë është e angazhuar në një sërë iniciativash. Të marrim një shembull të thjeshtë: luftën kundër informalitetit. Si mund të kontrollohet lëvizja e parave në zonat rurale? Kur paratë në to qarkullojnë në kesh, ose në të zezë. Pra, nuk ka një institucion ligjor që të masë kapilaritetin e lëvizjes së këtyre financave. Së dyti, ne themi që të çojmë shërbime aty ku është qytetari. Marrim një rast: pagesa e punonjësve. Marrim Ministrinë Arsimit. Sa mësues kemi ne në zonat rurale? Ndërkohë themi se atyre rrogën do t'ju japim nëpër banka. Përse këta mësues duhet të detyrohen të marrin autobusin ose mjetin më të afërt që kanë, për të shkuar në zyrën bankare për ta marrë? Atyre kjo u kushton kohë dhe para. Përse të mos e marrin rrogën në kanale bankare në shtëpinë e tyre? Duke patur një potencial të tillë, që është Posta Shqiptare, e cila ndodhet kudo, edhe aty ku nuk ka Komisarariat Policie, bashki apo komune, ku s'ka madje edhe ambulancë, por ama ka një zyrë postare. Posta është pika fundore e komunikimit të Shtetit me qytetarin.

Po arsimtarët në këto zona të largëta ku do ta marrin rrogën, tek postieri? Postieri do të bëhet bankier?

Do ta marrin rrogën në zyrën postare. Ne kemi zyra postare në çdo skaj të Shqipërisë. Pra, ja ku është një mundësi pozitive. Nga ana tjetër, ne themi që kohët e fundit qeveria shqiptare është e angazhuar në investime për përmirësimin rrënjësor të infrastrukturës. Gjë që të gjithë shqiptarët sot e prekin. Por ambicijet janë akoma dhe më të mëdha. Që ashtu sikurse janë bërë rrugët dhe magjistralet kryesore, të bëhen edhe rrugët rurale deri në kapilaritet. Kjo, për të siguruar një qarkullim të mallrave, të mundësive dhe ideve në çdo skaj të vendit. Këto natyrisht duan investime, fonde. Atëherë, përse të mos ketë Posta depozita të qytetarëve, një lloj si të gjitha bankat e tjera? Ne nuk po shpikim. Ne po kërkojmë një normalitet që ka zbritur dhe është ulur këmbëkryq në të gjithë Evropën. Posta do të jetë një bankë që depozitat e qytetarëve do t'i investojë në bono thesari, pra do të krijojë magjistralin e financimit të punëve publike. Dhe në rast se sot unë si politikan apo qytetar them se qeveria merr kredi për të rritur pagat apo pensionet, ky është një abuzim. Sepse dihet, ekzistojnë të gjitha mënyrat e kontrollit, që nga grupet parlamentare deri tek Kontrolli i Lartë i Shtetit. Çdo njeri mund të denoncojë. Por me banko-postëën kemi një proces transparent. Depozitat do të kalojnë të gjitha në bono thesari. Natyrisht, duke ruajtur likuiditetet për nevojat emergjente që mund të kenë depozituesit. Pra, procesi është transparent dhe qytetari ndihet shumë mirë, pse e sheh vetë se si lëvizin financat e shtetit. Nga ana tjetër, e ndjen veten kontribuues në zhvillimin e vendit. Por mbi të gjitha, Posta dhe Postë-banka, duke qenë institucione financiare shtetërore, janë jo vetëm mekanizma kontrolli dhe rregullimi të tregut, por mbi të gjitha, edhe fitimi që nxjerrin shkon për riinvestim për të mirën publike. Nuk kemi eksport të fitimit jashtë kufijve. Pra, po ta shikosh në laboratorin e logjikës financiare, gjithshka është e favorshme që ky hap të merret.

Po sistemi bankar deri tani ka qenë tërësisht privat, duke menduar se privati e kryen punën më mirë se shteti. Pse duhet shteti të futet në këtë sektor?

Demokracia është gjithmonë një sistem në kërkim. Duke qenë sistem në kërkim, ka dhe mundësinë e axhustimit dhe të rregullimit të gjërave. Po marrim rastin e vendit më të zhvilluar kapitalist, SHBA-ve. Aty u prodhua recesioni ekonomik që tronditi të gjithë botën, nga mungesa e kontrollit mbi institucionet financiare private. Ne nuk po shpikim, banko-posta është një realitet në të gjithë Evropën. E ç'të keqe do të kemi ne nga një formulë e sprovuar? Ne bashkëpunojmë me privat. Po atje ku s'është privati, duhet t'i lëmë njerëzit pa shërbim, derisa të vijë privati atje? Ne folëm deri tani për zonat rurale. Aty s'ka privat, s'ka shërbime bankare. Atëherë, këta qytetarë që jetojnë atje nuk

janë qytetarë shqiptarë? Nuk duhet të jenë këta të barabartë me afrimin e shërbimeve si të gjithë të tjerët? Duhet të jenë të privuar? Por akti themelor i demokracisë është që të gjithë njerëzit janë të barabartë. Mendoj se të gjithë kanë të drejta të barabarta për të marrë shërbime dhe për të paguar. Për të qenë klientë dhe konsumatorë. Por njëkohësisht edhe financues, edhe pagatorë, edhe kontribuues. Atëherë ja ku është një element shumë i thjeshtë që i mungon këtij realiteti financiar. Përse mos ta mbushim?

Përse nuk e keni kërkuar më përpara këtë funksion? Apo e keni kërkuar?

Nuk dua të marr pozicionin e kritizimit. E rëndësishme është që të bëhet. Edhe nëse unë apo të gjithë dashamirësit e kësaj iniciative nuk do të arrijmë ta kryejmë, do të vijë një brez tjetër që do ta bëjë. Ajo që përmenda edhe më parë, çdo nevojë e shoqërisë gjen stafin dhe zgjidhjen. Por mendoj që sot Banko-Posta shqiptare do të jetë një banko-postë e denjë jo vetëm për të debutuar brënda vendit, por edhe në familjen e vet evropiane. Ne tashmë si Postë i kemi marrë certifikimet e duhura ndërkombe-tare për nivelin e shërbimeve që kemi arritur.

Çfarë nënkupton për ju vlerësimi "Harku i Cilësisë për Evropën" që e keni marrë ditët e fundit?


Në vijim të atyre njohjeve dhe vlerësimeve ndërkombëtare që Posta jonë ka marrë deri tani, në Frankfurt ne morëm një çmim që titullohet "Harku i Cilësisë për Evropën". Me thënë të drejtën, e kemi ndjerë veten mirë. Jo vetëm pse u vlerësua puna jonë. Por një ndërmarrje shqiptare ishte ndërmjet 62 vendeve dhe 150 kompanive përkatëse që konkurruan dhe që mori një nga çmimet më të larta. Ishin shumë pak të kësaj cilësie. Të tjerët morën çmime të kategorive më të vogla. U ndjemë mirë, jo vetëm pse jemi në rrugë të mbarë, apo pse jemi pjesë e integruar e qeverisë shqiptare drejt Bashkimit Evropian. Në fund të fundit, vlerësimi është pjesë e erës që po fryn dhe në mentalitetin ndërkombëtar për vendin tonë dhe për aftësitë e shqiptarëve.

Një mesazh tuajin, zoti Gorea, për ata që ju i quani mbretërit tuaj, klientët, sidomos fshatarët shqiptarë, banorët e zonave rurale.

Mesazhi im është ky: e jani dhe na takoni! Dhe mos mendoni për të mirat e Postës Shqiptare. E mira e Postës Shqiptare janë vërejtjet tuaja në adresë të shërbimit që merrim. Ne kemi një numër falas: 08004141, me të cilin të gjithë qytetarët e Shqipërisë mund të komunikojnë me Qendrën e Monitorimit të Postës Shqiptare. Të gjithë ata qytetarë që na kanë telefonuar, kanë komunikuar me ne dhe kemi ndjekur çdo rast të raportuar prej tyre deri në detaje, duke i informuar për rezultatet. Ne jemi një kompani në tranzicion, sikurse është e gjithë shoqëria shqiptare. Megjithë sukseset, kemi nevojë të korrigjohemi. Pa u korrigjuar, rrezikon suksesin, rrezikon përparimin. Ne kemi shumë nevojë për klientët tanë, jo vetëm si pagatorë, por si pjesëmarrës në zhvillimet që ka kompania jonë. Ata do të na ndihmojnë me sugjerime dhe me konstatimet e tyre. Ne nuk kemi nevojë vetëm për fjalë të mirë. Kemi nevojë edhe për sugjerime dhe për denoncime aty ku gjërat nuk shkojnë.




Keni pasur denoncime nga qytetarët?

Po ka pasur, në atë funksionin e mbi 300 vetëve që janë larguar nga Posta Shqiptare, janë edhe denoncimet dhe provat që na kanë ardhur nga qytetarët shqiptarë. Unë i falenderoj ata dhe uroj që numri i tyre të shtohet. Pse Posta Shqiptare është ndërmarrje e tyre. Në çdo gjë që ne përmirësohemi, është në të mirën e tyre. Nëse punët tek ne nuk venë mirë, është në të keqen e tyre. Prandaj kjo është kërkesa që unë kam. Dhe i garantoj që nuk do të jemi hatërbetës. Përkundrazi. Do t'i konsiderojmë si qytetarë që bashkohen në rrugën tonë dhe dëshirojnë që Posta Shqiptare të jetë përditë dhe më afër tyre, përditë me një shportë jo vetëm me shërbime të reja, por edhe shërbime cilësore.



CMYK

REKLAMA



ENERGJI

ENERGJI

Ne ndërtojmë Energji



ENERGJI SH.P.K

Adresa: Rruga "Mihal Grameno"

Pallati 94, shkalla 2, ap.25 Tiranë



Publisa
Everest

“RAJFI Group”

Fuqia e Ndërtimit në zemër të Durrësit


Codina multifunkionale
Bashkëpunim me studio të njohura projektuese nga Piemonte
Avantgardë e studimeve urbanistike për qytetin bregdetar
Pioniere e cilësisë në lëmin e import-eksportit

Kontakti: “Lagja nr.4, Rr. Skënderbej”, Durrës

Shtëpia Botuese "55"

Ribotimi

["Zonja e Zezë..." e Fahri Balliut, në ribotimin e 9-të të saj]



Në libraritë kryesore të vendit, është hedhur në qarkullim ribotimi i 9-të i best-sellerit "Zonja e Zezë Nexhmije Hoxha", të publicistit Fahri Balliu, me parathënien e shkrimtarit Ismail Kadare. Publikimi është i pajisur edhe me shënimin e fundit të autorit, për lumin e fakteve të reja për karakterin kriminal të personazhit kryesor të monografisë

Botimet e reja

Me Posta Shqiptare mbi 2 milionë e 42 mijë shtetas kanë marrë kuponin për kartat e identitetit

Pasaportat biometrike, mbi 796 mijë shtetas marrin kuponin në zyrat postare

Shqipëria vazhdon të jetë vendi me ritmin më të lartë në rajon për pajisjen me dokumente modernë identifikimi si; letërnjoftime elektronike dhe pasaporta biometrike. Jo vetëm deklaratat e bëra nga ministri i Brendshëm Lulëzim Basha dhe të tjerë zyrtarë të qeverisë e vërtetojnë një këtë gjë bazuar në prodhimin e këtyre dokumenteve modern identifikimi, por dhe statistikave të shitjes së kuponëve në sportelet e Postës Shqiptare flasin për një të vërtetë të tillë. Interesi i shtetasve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit po rritet dita-ditës. Kjo flet qartë për një ndërgjegjësim të qartë qytetare për t'u pajisur dhe prezantuar në vendet evropiane për nga vijnë dhe duan të shkojnë me dokumente moderne identifikimi. Shtetasit që do të kërkojnë një pasaportë të re, duhet të shkojnë në zyrat e Postës Shqiptare, të paguar 6000 lekë të reja e më pas të drejtohen për në zyrat e aplikimit ku prodhimi i pasaportës së re është identik me procedurat e ndjekura deri më tani për pasaportat aktuale. Kujtojmë këtu që pasaporta e vjetër zhvleftësohet vetëm në momentin e marrjes të së resë. Posta Shqiptare si gjithnjë vazhdon ta vlerësojë maksimalisht procesin e



pajisjes së qytetarëve me kuponë për letërnjoftimet elektronike si një proces kombëtar duke angazhuar të gjitha strukturat e shërbimit në realizimin sa më dinjitoze të këtij procesi për shtetasit shqiptar duke krye më se miri këtë detyrë kombëtare ndaj klientëve të saj, këtë mision fisnik, këtë shërbim ndaj qytetarëve me qëllim që ata të mund të marrin sa më shpejt dokumentin moderne të identifikimit (pasaportë ose kartë). Punonjësit e shërbimit postar vazhdojnë të jenë vigjilent kanë mundur të jenë pranë çdo qytetari jo vetëm duke

kryer detyrën e tyre si punonjës të një kompanie e shërbimit dhe shërbesave. Në këtë mënyrë në të gjithë Shqipërinë përmes rrjetit postar të Postës Shqiptare deri të premtën janë shitur mbi 796 mijë kuponë për pasaportat biometrike dhe rreth 2 milionë e 42 mijë për kartat e identitetit në të 551 zyrat postare të cilat mbulojnë të 470 njësitë e aplikimeve. Strukturat e Postës Shqiptare kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në funksion të këtij procesi gjatë gjithë ditëve të javës duke e vlerësuar maksimalisht si një proces jashtëzakonisht

të rëndësishëm. Procesi i pajisjes së qytetarëve me kuponë me qëllim aplikimin për letërnjoftimin elektronik dhe pasaportat biometrike po ecën shumë mirë në të gjitha sportelet e Postës Shqiptare në shkallë vendi. Punonjësit e shërbimit postar janë në gatishmëri çdo ditë të javës për të gjithë qytetarët e interesuar. Ministri i Brendshëm Basha por edhe kryeministri Berisha iu kanë bërë thirrje publike qytetarëve dhe ftuar ata që të pajisjen me pasaporta biometrike pasi zotërimi i një dokumenti të tillë përbën në çdo kohë avantazh në

kërkesat për pajisje me viza për jashtë shtetit. Në këtë drejtim shtetasit shqiptarë do të duhet të heqin nga përdorimi pasaportat aktuale pasi kjo do të çonte lëvizjen e lirë të tyre pasi heqja e vizave dhe tashmë është çështje kohe pajisja me këto dokumente modernë identifikimi do të iu mundësojë atyre lëvizjen e lirë drejt vendeve të BE-së.

Qytetarët duhet të nxitohen të pajisen me pasaporta biometrike. Pajisja e shtetasve me dokumentin modern të identifikimit do të ishte në të mirë të vendit.

QSUT: Realizohen 90 % tenderave, mjekët - të shkurtohen dhe afatet



6 mujori i parë i këtij viti shënon realizimin me 90 përqind të tenderave bazë sa i përket barnave dhe citostatikëve. Këto të dhëna i publikoi dje drejtori i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Ilir Dashi, i cili theksoi se gjatë 6-mujorit të parë janë realizuar një pjesë e mirë e investimeve dhe tenderëve në këtë institucion, duke iu referuar vetëm paketës bazë dhe citostatikëve, të cilët janë realizuar 90 përqind, ndërsa janë shpenzuar 621 milion lekë për paketën bazë të barnave dhe 507 milionë lekë për citostatikët. "Puna e bërë deri më tani është një sukses i plotë nga ana jonë. Janë realizuar 90 përqind të tenderave, ndërkohë që edhe pjesa e mbetur e tyre janë në rrugë e sipër", deklaroi Dashi. Ai vuri theksin në rritjen e buxhetit për vitin 2010, si për barnat bazë ashtu edhe për citostatikët. Sipas të dhënave për barnat shënohet një rritje prej 67.57 përqind më

"Puna e bërë deri më tani është një sukses i plotë nga ana jonë. Janë realizuar 90 përqind të tenderave, ndërkohë që edhe pjesa e mbetur e tyre janë në rrugë e sipër", deklaroi Dashi. Ai vuri theksin në rritjen e buxhetit për vitin 2010, si për barnat bazë ashtu edhe për citostatikët"...

shumë se viti 2009, kurse për citostatikët një rritje prej 60 përqind. Dashi bëri të ditur se tenderat e materialeve të mjekimit përfundojnë në fund të muajit korrik, ndërsa afirmoi se janë realizuar një pjesë e mirë e tyre. Drejtori i QSUT-së, nënvizoi se kanë përfunduar tashmë të gjitha kontratat e mirëmbajtjes së aparaturave, ushqimit, lavanterisë, energjisë dhe ujit. Ndër të tjera ai pohoi se është lidhur edhe kontrata për pastrimin e jashtëm të territorit të

QSUT-së si dhe ajo e ruajtjes së objekteve. Sipas drejtorisë së QSUT-së, treguesit në këta gjashtë muaj të parë të vitit është me një mijë numri i pacientëve, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të shkuar. Por, bluzat e bardha kërkojnë tashmë ndryshimin e Ligjit të Prokurimeve për ilaçet dhe materialet mjekësore për shkurtime të afateve kohore, që sipas tyre do të bënte të mundur realizimin e tenderëve në një kohë më të shkurtër në mënyrë që të gjitha barnat të jenë prezentë në pavijone në të njëjtën kohë. Dashi ka dhënë një shembull konkret ku pas lidhjes së kontratës, ligji parashikon që firma fituese të sjellë furnizimin e ilaçeve për 15 ditë deri në 45 ditë, që shpesh është e gjatë si kohë, duke iu referuar emergjencave. Ndryshimi të lidhjes së kontratave me grosistët, do të plotësonte nevojat me medikamente në një kohë më të shkurtër.



Familja e Taushanëve në rrjedhën e shekujve

DOSSIER

Nga Hyqmet Kotherja

Të merresh me gjenezën e familjeve të mëdha shqiptare është një punë me vlerë. Të japësh përgjithësime në baze të hulumtimeve s'është gjë tjetër veçse një kontribut modest në historikun e familjeve shqiptare, pozitës shoqërore, rolit të saj politik, ekonomik në thellësinë e shekujve. Të rralla, në mos unikalë, janë ato familje rrënjët e se cilës i gjene për një kohë gjysëm mijëvjeçare deri në ditët e sotme. Vlen të shqyrtojmë derën e madhe të familjes elbasanase, Taushani, të parët e se cilës i përkasin kohës kur sundonin principatat feudale shqiptare, kur epoka Bizantine gjendej në grahamat e fundit të jetës së saj. Sikurse dihet, Arianitët ushtronin autoritetin e tyre në krahinat Shpatit, Çermenikës, Krrabës, Sopotit etj. Kryeqendra e principatës ka qene qyteti i Valmit dikur i shkatërruar nga dyndja e fiseve barbare. Vendlindja e Mosi Golem Arianit, bashkëpunëtori me i ngushtë i Skënderbeut (M.Barleti, Historia e Skënderbeut, T,1967.). Pikërisht këtu, me 1403, ndeshemi me të parin e familjes së Taushanëve Miko Skifteri, despotin e qytetit të Valerjanit (Valmi) me të cilin nis e hedh shtat kjo familje trug madhe. Princat e fisnikët shqiptare sikurse Arianitët kane patur marrëdhënie të shkëlqyera me shtetet italiane prej të cilëve konsideroheshin si mburoje e kristianizmit. Në veçanti përmendim Venedikun për shkëmbimet tregtare. Arianitet blinin nga Venediku stofra për përdorim familjar e të njerëzve të shërbimit, këtë, na e dëshmon edhe akordi i Skënderbeut me Venedikun, me 1448, për përjashtimin nga taksat doganor të familjes së Arianitit (A.Gjergji, Etnografia Shqiptare, nr.7, 1975). I biri i Miko Skifterit, Petro Bozo, me 1430, martohet me Venedikasen N. Kontarini. (Eqrem bej Vlora...Kujtime.).Ka të ngjare që në kembimet tregtare të Arianiteve me Venedikun të jete përfshire dhe Petro,si njeri i besuar i tyre duke u inkuadruar në parine tregtare.

Në fillim të shekullit XV-te shteti osman turk kish filluar të depertonte thelle në Ballkan.Ne vitet 1423 – 1426 turqit arritën të pushtonin të gjitha viset e Shqiperise se ulet beregdetare dhe me 1432 filluan regjistrimin e përgjithshëm të tokave duke i klasifikuar në toke shteterore, toka private të fshatareve e qytetareve dhe toka vakefe. Rrudhje të

ndjeshme të zotërimeve tokesore pësuan arianitet të cilët pas viteve '50 e lane luftën kundër osmanëve. Te diktuar nga keto rrethana trashëgimtare e familjes Arianiti, për të mos humbur pronësinë mbi token shndërrohen nga të krishterë në myslimane. Procesi i islamizimit, do t'u epte mundësi atyre të futen në shërbim të osmanëve, të ruajnë privilegjet e tyre dhe të inkuadrohen në karrierën administrative të aparatit shtetëror turk. Keshtu ndodhi me Basanian, djalin e despotit (Gjergj Arianitit - H.K.) që sipas Evlia Çelebise në mesin e shekullit XV-te iku dhe kerkoj mbrojtjen e Sulltan Mehmetit të dytë dhe në prezenca të tij kthehet në mysliman.me emrin Mehmet bej.Nën komandën e Mahmut Koço Pashes, Mehmet beu, me një ushtri prej 40 000 vetesh, pushtojnë qytetin e Valmit me 1466. Pas pushtimit të qytetit nga turqit, Valmi u emertua Elbasan (vura dore).Keshtu, Mehmet beu mori në dorë qytetin i sunduar nga babai i tij dhe lajmëroi sulltanin i cili u gezua shumë dhe e emëroi atë, sanxhakbeun e parë të Elbasanit. Kete variant e përmendin dhe autorë tjetër. Emrin Mehmet e gjejmë të trashëgueshëm prej kater shekujsh në familjen Taushani Familja e Taushaneve me trashëgimtarët e saj ishte paria e vendit. Ajo filloi me 1450 me Mehmet beun që u bë vezir dhe perfundoi me Mehmet Pashe Taushanin, i vrare në Cemenike me 1843.

Taushanet e Janines Ali Asllan Aga, i biri Mustafa ages, me 1550, shkeputet nga familja Taushani në Elbasan dhe vendoset në Janine.dhe martohet me të motren e Vezirit të Madh, Lytfi Pasha, nga Libohova. I nipi Aliut, Zylfikar aga, behet myteselim i Janines (1550- 1579), sanxhakbej (1560-1601) dhe ndërtoi në mes të Janines xhaminë e Flamurit.Ne 1560, lind i biri, Ali Asllan Pasha (Caushi) i cili behet vezir dhe Sanxhakbej i Janines (1601 – 1609). Po kete vit behet bejlerbej i Rumelise dhe eshte vlerësuar ndër burrat me të shquar me periudhën e lulezimit të Perandorisë Osmane. Asllani Pash u vra në betejën e Sezenit në Persi me 1617. (.E. Libohova, Kujtime f.568) Pe ndër të tij familja Taushani u quajt Asllanpashalli. Vetem në Janine ga kjo familje kane qeverisur 22 sanxhakbejlere dhe kane rene në fise të betejës 3 vezire e 4 pashallarë. Po sipas Eqrem bej Vlores, Ahmet Pasha, eshte shquar në disiplinën e artilerisë dhe ishte komandant i artilerisë në fushatën kundër Persise. Pas fushatës vendoset në Stamboll. Sundimtarët

elbasanas dallohen për rregullimin e infrastruktures në hapësirën që qeverisin.

Taushanet e Vlores

Sipas historianit Selami Pulaha,veziri Mehmet Pashe Taushani, sanxhakbej i Elbasanit, është emnue sanxhakbej në Vlore dhe në vitin 1486 është vrare në Himarë. I nipi Gjergj Arianitit, Ali beu (Taushani) zoteronte në 1506 ziametin e Dibrikut në sanxhakun e Vlores dhe në 1526 – 1527 emërohet sanxhakbej i Prizrenit. S. Pulaha, Pronesia feudale në tokat shqiptare në shek. XV- XVI, f.61.

Në vitin 1764, Taushanet i gjejmë në radhët e parisë së qytetit të Vlores dhe pjesëmarrës aktiv në jetën politike të qytetit. Keshtu, kete vit vritet veziri i Beratit dhe Vlores, Ismail Pashe Velebishti (Vlora) në shtepinë e Ismail bej Taushanit i cili kishte për

shqip. Në maj të vitit 1902, me Etem bej Risilina e bashkeluftetare transferohen nga burgu i Beratit në atë të Janines. Ata burgosen nga osmanllijet sepse në shtepite e tyre u janë gjetur libra e gazeta shqip. (AQSH. F.143.D.47).

Në kulmin e fuqisë të shtetit feudalo ushtarak turk në shek XVI-XVII-te pozita politike e Taushaneve gjithmone e me shume forcohet. Ata i gjejmë qeveritar të perhershëm në Janine, Elbasan,Vlore , Prizren,Delvine e në shume vende të tjera të perandorisë osmane.Ne Janine posti i sanxhakbeut behet pothuajse i trashëgueshëm nga familja Asllanpashalli. Taushanët, kane qeverisur Gjirokastrën dhe Thesalinea me qendër në Delvine sikurse ka qene Abdulla Pashe Taushani sanxhakbej i Delvines në vitin 1740 (Revista Leka, Viti 1944, fq. 286).

Eshte karakteristik fakti se emrat e sundimtareve do të perseriten brez pas brezi në trugun familjar të Taushane cka lehtëson evidentimin e tyre sikurse do të shohim në vijim. Kronisti turk Evlia Çelebia në vitin 1670 për Elbasanin do të shkruaj " Shtepite e medha të parisë së qytetit perbehen nga shtepia veziriale e Mehmet Pashes (Taushani), Mehmet Ages (Taushani), Mustafa Ages (Taushani),Qemal Zade, Karaosman Ages, etj. Shtepia veziriale e Taushanave e blere me vone nga Sejdimi e Sokoli (sot muzeu etnografik e ngrhina) shërbente si shtepi pritjeje për okomodimin e autoriteteve të larta shterore dhe ushtarake turke. Ndersa shtepia e Gjylbegut dhe e Ndrçim Pllangarices ishin shtçpia ku banonin familja dhe shërbëtoret. Kronisti turk do të përshkruaj me hollësi qytetin e Elbasanit dhe ngre lart bukurinë e hijeshin e tij. Midis të tjerave do të përmende objektet e kultit kryesisht faltoret dhe veçon atë me të vjetrat Xhaminë e Mehmet Konkuistorit (Pushtuesit) në kala, xhaminë e Taushanëve, në Bezistan e thirur nga populli xhamia e lepurit etj. Lagja ku jetonin taushanet mori emrin Asllan bej për ndër të Asllan bej Taushanit që shkoi në Janine dhe nipit të tij Asllan Pashese që ishte ndër burrat me të shquar në periudhën e lulezimit të perandorisë osmane. Kjo lagje eshte thirur keshtu deri nga mesi i shekullit të kaluar..

Në shekullin XVIII fillon shturja e sistemit feudal – ushtarak turk e cila solli si pasoje dobësimin e pashmangshëm të pushtetit qendror të sulltanatit aq me teper administratën shtetërore të perandorisë. Turqia e

Në fillim të shekullit XV-te shteti osman turk kish filluar të depertonte thelle në Ballkan.Ne vitet 1423 – 1426 turqit arritën të pushtonin të gjitha viset e Shqiperise se ulet beregdetare dhe me 1432 filluan regjistrimin e përgjithshëm të tokave duke i klasifikuar në toke shteterore, toka private të fshatareve e qytetareve dhe toka vakefe

grua hallen e vezirit.. Rrebelimi kundër turqëve u bë nga veziri kur ai ishte sanxhakbej i Lepantos dhe u shpall fermanli. Në Vlore ai u perkrah nga një pjesë e parisë me në krye Ismail bej Taushanin ndersa pjesa tjetër e parisë abstenoj (Eqrem bej Vlora. Historia e kalasë së Kanines. Rome 1960). Pasardhesit e tyre i hasim po në Vlore si Ali bej Taushani, Ismail bej Taushani, Zyber bej Taushani, Xhelal bej Taushani,, Xhaffer bej Taushani. Emrat Xhelal e Ali jane të trazhuara nga familja Taushani në Vlore deri në ditët e sotme. Eqrem bej Vlora për Zyber beun thote se ai vinte nga një familje të njohur fisnikesh nga Elbasani. Ai ka qene mik me koke i tij ... një fare kalorësi i vetete që nuk njihte frike e skrupull,nje kabalero i vertete veshur me kostumin piktoresk kombetar, një vigan floke verdhe që do të futej fare mire në suazen e shekullit XIV-te.. Zyber beu e mbante vehten për një fare palatini të fisnikerise se vjeter qytetese...nje Lorenzo Magnifiko i vertete i dale drejtpërsëdrejti nga tabllote e Rilindjes....(Eqrem bej Vlora....f.34 dhe 79). Vec Zyberit, emer të mire ka lene dhe Ali bej Taushani, i përfshire në rrethet patriotike shqiptare në Vlore e rrethinat e saj në perhapjen e gjuhes e të shkrimit



humbi shkëlqimin e shekujve paraardhës. Gradualisht fillon fuqizimi ekonomik e politik të sundimtareve të cilët kërkonin të shkëputeshin përfundimisht nga Porta e Lartye. Per shkak të grindjeve, konflikteve vrasjeve, Porta e Larte, beri kujdes që detyren e mytesarifeve t'u a besonte perfaqesuesve të oxhaqeve me të fuqishme. Oxhaqet që luajten një rol të rëndësishëm politik dhe ekonomik në vendin tone u bene në Shkoder Bushatllinjte dhe Caushollajt, ne Peje Begollajt, ne Gjakove pashallaret vendas, ne Elbasan Taushanet e Bicakcijte, ne Vlore Velabishtajt e Vlorajt, ne Delvine Kapllanpashallijte (Taushanet), ne Kruje Toptanet , ne Kavaje Alltunet etj. Stavri Naci, Pasahalleku i Shkodres nen sundimin e Bushatllinjve Tirane 1964 fq.34.

Krijohen zoterime të trazgueshme nga feudalet vendas, pashalleqet, ne Shqiperine veriore Pashalleku i Shkodres (1757-1837) nga Bushatllijte e Caushallajt dhe ne Shqiperine jugure, Pashalleku Janines me Ali Pashe Tepelene (1786 – 1822). Nga oxhaku i Taushaneve ne Elbasan ka petur 3 vezire e 8 pashallare deri ne mesin e shekullit XIX-te, si Mehmet Pashe Taushanin , vezir (1455), Ali Pasha, Abedin Pasha, Abdurrahim Pasha (1669 – 1686), Mehmet Pasha, (1792), Abdulla Pashe Taushani, (vdekur me 1820), Mehmet Pashe Taushani (vrrarë ne Çermenikë me 1843).

Ne muajt maj qershor 1797, Porta e Larte, njohu Ibrahim Pashe Shkodranin qeveritar te Shkodres nderesa nipin e tij Mehmet Pashen qeverisjen e Sanxhakut te Elbasanit. Ne 1802, Sanxhaku i Elbasanit iu dha vezirit te Beratit Ibrahim Pashe Vlores. Me te marre ne dorezim sanxhakun Ibrahim Pasha deboi idhtarit e Ali Pashe Tepelene, Abdulla Pashe Taushanin, i cili shkoi ne Janine dhe hyri ne mbrotje te tij. Pa u mbushur viti, ne vere te vitit 1803, Abdulla Pasha kthehet ne Elbasan. Rikthimi u be nga nderhyrja e Ali Pashes tek Ibrahim Pasha i cili nuk e kundërshtoi. Ishte koha kur Ali Pasha Tepelena kryente funksione e valiut te Rumelese i cili shkarkohet nga kjo detyre nga Sulltan Selimi III nga frika e fuqizimit te Aliut. Vendin e tij e ze Ibrahim Pashe Bushatlliu. Ibrahim Pashe Vlores forcon bashkëpunimin me armikun e tij te vjeter, Ali Pashen duke rikthyer Abdulla Pashen ne qytetin e tij dhe te ndermarre pastrimin nga tarafet e Bushatllinjve, Bicakcijt dhe Vërlacët te lidhur me krushqit midis tyre. Nga frika Mahmud Pashe Verlaci largohet nga Elbasani Valiu shkodran ne shenja hakmarrje, me aprovim te Stambollit largoi vezirin beratit duke e zevendesuar me dhëndrin e tij Ahmet Pashe Tiranen (Bargjini). (Stavri N. Naçi, Pashalleku i Shkodres, Tirane 1986.)

Veziret e Shqipërisë jugore sulmuan me 1805 zotërimet e Ibrahim Pashe Bushatlliu ne Shqiperine qendrore dhe ne Oher. Ibrahim Pashe Vlores u përpoq te marre Elbasanin por dështoi tetor 1805. Keshtu, qyteti mbeti ne duart vezirit shkodran, deri ne shkurt te vitit 1809, koha kjo qe korrespondon me vdekjen e vezirit shkodran. Pas vdekjes zotërimet e tij pësanur rrudhje te madhe. Ka gjasa qe brenda ketij viti si sanxhakbej i Elbasanit behet Abdulla Pashe

Taushani. Ne Elbasan Abdulla Pasha punoi per dy vjet (1912-1813) per higjienizimin e qytetit duke pastruar kanalim kryesor te ujërave te zeza e te bardha qe niste nga Kalaja dhe perfundonte ne lumin e Shkumbinit. (AQSH Kodiku i Elbasanit viti 1813). Gjithashtu mbylli dy dyert e jeniçerëve te kalase. Ai do te qendroi gjate ne kete detyre deri ne vitin 1820.

Ali Pashe Tepelena lidhet me Pashen e Elbasanit i kishte te hershme me krushqitë qe kish bere. Martesa e pare e Aliut e bere rreth vitit 1766 ne Janine me Eminene. Ajo ishte bije e Ali Kapllan Pashes (Asllanpashalliu – Taushani) sundimtar i Gjirkastres dhe Delvines. Emineja ishte e nipit te Haxhi Mehmet Pashes, burrit te Belkis Taushanit, bije e Abdulla Pashes se pare. Martesa e dyte, u be me Zeliha Asllanpashalli qe ishte nuse tek dera me e rëndësishme dhe me e passur e Janines. Kjo ishte e veja e Ahmet Pashes, nip i vezirit (djali i djalit) te Ballkis Taushanit. Keto lidhje i sherbenin qellimit te larte, shkeputjes se Shqipërisë nga kthe-trat turke. Nga kjo koha fillon nje epoke e re per Taushanet. Ato si aleatet me te ngushte te Ali Pashe Tepelene do te qëndrojnë ne balle te luftes anti-osmane.

Pashalleku Janines përfshinte sanxhakët e Terhalles, Lapantit, Janines, Vlores, Elbasanit e Ohrit, 14 kaza te sanxhakut te Manastirit dhe 3 te sanxhakut te Selanikut. Per te qeverisur kete teritor te madh mban-te nje ushtri prej 15 000 vetesh, ne koha lufte trefishin etj. Pervc kembesorise kishte kalorine, artillerine dhe floten luftarake. Ne krye te ketyre forcave ushtarake qendronte Keshilli Larte Usharak, te drejtuar nga Ali Pashe Tepelena. Anëtare te ketij keshilli ishin mekembesit e tij ne sanxhake, si Myftar Pasha (i biri), Veli Pasha (i biri), Xhaladin bej Ohri, Abdulla pashe Taushashani etj, (Histori e Shqiperise, Vol.2. viti 2002). Abdulla pashe Taushani duhej te kalonte permes shtegut te Taushaneve ne Dumre per te qene prezent ne kete organ te larte vendimarrës.

Vendin e Ibrahim Pashes e ze Mustafa Pash Shkodrani, ne maj te vitit 1812. Pasi eleminoi kundërsh-tarët e tij ne qytet, deri ne vitin 1819 zgjeroi zotërimet duke nenshtuar pashallaret kosovare dhe Dukagjinit. I nxitur nga Divani perandorak kunder Ali Pashes, Mustafa Pasha merr sundimin e Sanxhakut te Elbasanit dhe te Ohrit dhe me 2 qershor 1820 niset per pushtimin e tyre. Pas pushtimit te Tiranës, Durrësit, Krujes, Bushatlliu nis nje leter drejtuar parësisë se sanxhakut te Elbasanit per te debuar njerzit e Ali Pashes me te mire. Me te marre vesht se Mustafa Pasha ndodhej ne rrugë per ne Elbasan paria filloi te vepronte me zell sepse sapo kish vdekur zevendesit i Ali Pashes , Abdulla Pashe Taushani. Ne krye te parisë vihet i nipi Abdulla Pashe, Mehmet bej Elbasani, (Taushani) dhe nip i Abaz bej Dibres te cilin e kishte dajë. Afro 600 ushtarë toske nga kalaja e Elbasanit u larguan sikurse dhe ato te kalave te Suloves, Verces etj. (Stavri Naçi Pashalleku i Shkodres, Tiranë, 1986). Mustafa Pasha lufton kunder Ali Pashe Tepelene. Fundi i pashalekut te Janines do te jete dhe fundi i pashallëkut te Shkodres dhe i pashalleqeve Shqiptare. Turqia doli triumfuese.

Familja elbasanase e Taushaneve pas viteve 20' nuk do te kete ate forcen e madhe te dikurshme, ajo do te ringrihet ne fillim te dekares se pare te shekullit XX. Ne etapen e fundit te epokes se Rilindjes, Elbasani, u be nje nder qendrat me te rëndësishme te levizjes kombëtare Shqiptare. Krijohen klube e shoqeri progresiste ne përhapjen e gjuhës e te shkrimit shqip. Ne 13 shtator 1908, krijohet klubi "Bashkimi" dhe ne 5/18 prill 1909 klubi "Vllaznia" me kryetar Dervish Himen. Ne perberje te ketij klubi benin pjese atdhetar me emer, si Lef Nosi, Hysen Ceka, Fot Papa-jani etj. Ne keshillin organizativ ben pjese dhe Isuf bej Taushani. AQSH, Fondi 102. Klubi Vllaznia do te luaj nje rol te qenesishem ne rritjen e ndërgjegjes kombëtare ne qytet e krahina. Veprimtaria atdhetare e Isuf bej Taushanit do te vijojë deri ne shpalljen e pavarësisë se Elbasanit me 25 nëntor 1912. Ky akt madhor do te nënshkruhet edhe nga dy pjesëtare te familjes Taushani, Isuf bej Taushani dhe Ismail bej Xheladin bej çka do te thote se ata përfshiheshin ne eliten atdhetare te qytetit. (L Nosi Dokumente Historike, Nr.2, prill 1924). Ate dite qe u shpall independenca Shqiptare, më 28 nëntor 1912, u krijua e para prefektura shqiptare me prefekt Aqif Pashe Biçakçiu. Ne organiken e ketij institucioni vendor Aqif Bicakciu do te emeroi Isuf bej Taushani me detyren e mbulimit sektorit te pyjeve ne qark. Me pas do te behet sipërmarres taksash. Pushtuesi Austriak (1916-1918) per nevoja ushtarake, sekuestronte kafshe ngarkese dhe baze ushqimore, Isuf bej Taushani, e konsideronte push-tuesin e huaj regjim vrases e mizor prej te cilit kishte humbur te afermin e tij, Abaz bej Taushanin. I mbushur tere urrejtje refuzon sekuestrimin. Per kete kundërshtoi okupatorët i dogjen shtepine me vlere 500 fr.ar. AQSH, F.271, D 26. Per shak te moshës Isuf Taushani terhiqet nga jeta politike dhe ne vitin 1929 nderron jete.

Abaz bej Taushani, simbol i mbrojtës se vlerave monumentale Shqiptare

Abaz Taushani ka qene i fundit i Taushaneve qe sakrifikoi jeten per hire mbrojtjes se trazgimise se kultures materiale shqiptare. U lind ne Elbasan me 1889 Ishte i biri Ismail bej Taushanit dhe i Alemshahut e dale nga familja intelektuale Ceka. Mesimet e para i merr ne qytetin e lindjes dhe arsimin ushtarak ne Itali.

Pas shpalljes se independences se Shqiperise rreshtohet ne formacionet e Qeverise se Vlores. Me ardhjen e Pric Widit inkuadrohet ne ushtrinë e qeverise se Princ Vidit. Kur qeveria e Athines krijoi te ashtuquajtur " Levizjen Epiriote " greket sulmojne pjesen jugore te Shqiperise. Ne fshatra te Kolonjes sipas Skender Luarasit ata bejne kerdine duke therur e djegur gra e femije. Ne ndihme te banoreve erdhen kompania e major Ahmet Leperiences, toga e toger Abaz Taushanit dhe e Fadil Kurtit duke çliruar fshatin Luaras nga duart e andarteve greke ne prill te vitit 1914. (S. Luarsa, Isa Boletini, f.203, T.1971).



Ne janar 1916 kur forcat bullgare vershuan drejt lindjes shpartalluan ushtrine serbe dhe hyjne ne Elbasan ne te njëjtën koha me forcat shqiptare te komanduara nga Ahmet Zogu. Ne kete formacion luftarak bënte pjese edhe Abaz Taushani. Me 18 shkurt Elbasani okupohet nga austriaket. Me urdhër te komandës supreme austrike Ahmet Zogu me ushtrinë e tij dislokohet ne jugë te lumit Vjose i cili ishte kufiri natyror austriako – italian.

Gjate kryerjes se shërbimit ushtarak ne Pojan te Fierit, kuadrot ushtarake shqiptare indinjohen nga akti i grabitjes se objekteve arkeologjike nga austriaket dhe per kete protestojnë. Menjëherë tre oficerët shqiptar midis tyre dhe Abaz Taushani arres-tohen e burgosen. Disa dite para ekzekutimit, Abazi, i dërgon nje leter babait te tij ku nder te tjera shkruan se ka shërbyer me besnikëri Mbrterise Austriake, se eshte i pafajshem dhe per kete kerkon te njoftohen te gjithë bashkatdhetarët ... kerkon te pershendese pjestare te familjes e te afermit. Ne vijim shkruan " Ushtria Austriake po me ve ne plumbt". Letra perfundon me thirrjen domethënëse: "Rrofte Shqipëria", "Rroftë Princ Widi". (Lef Nosi, Dokumenta Historike per t'i sherbye Historise t'one Kombe-tare, f. 189). Ketu prezantohemi me bindjet politike te Abazit, partizan i plat-formes politike te Widit per krijimin e Shqipërisë etnike. Ne qytetin e lindjes, Aqif Pasha Bicakciu ishte udhëheqësi i levizjes se fuqishme vidiste per te cilin ishte idhur. Abaz Taushani u zhgenjye nga demagogjia e pushtuesit te huaj sikurse shume personalitete te levizjes Kombetare Shqiptare.

Me 4 qershor 1916 ekzekutohen, tre oficeret Shqiptare, Kamber efendi Permeti, Behexhet efendi Kalkan-delen dhe Abaz Taushani nga Elbasani. Ky akt makabër indinjo i pa mase mbare opinionin kombëtar shqiptar. Shtypi italian i kohës gazetate "Voce dela Vlores", "La guerra Italiana" shkruajnë për "...pushkatimin në Fier te tre patriotëve shqiptar...ky i fundit (A. Taushani - HK) ka mbaruar studimet në Itali dhe kish shërbyer në regjimentet italiane...". Ata vazhdojnë "Letrat që kane ardhur nga ana e miqve tonë, dëshmitarë të rëndësishëm të prepotencës austriake tregojnë këtë akt te mizorisë..." (AIH, Vlore, 9 shtator 1916).

Qeveria austriake shqetësohet per kete ngjarje diskretituese. August Kral, autoriteti me i lartë austriak ne Shqiperi, me kërkesë të Ministrisë së Jashtme të Austrisë, i dërgon një raport nga Shkodra me 9 shtator 1916 eprorit të tij për rrjedhën e këtij incidenti. Midis të tjerave motivon sh-

kakun e vrasjes se tre oficerëve shqiptar me akuzën "...për krim kundra fuqisë ushtarake sepse kane nxitur ushtaret te braktisin pozicionet...". (AIH, Shkoder 16 shtator 1916).

Grabitje e objekteve monumentale ka qene një fenomen i shfaqur gjate gjithë kohës së pushtimit. Atë nuk e kryenin vetëm ushtarake te veçante por në mënyre të organizuar nga autoritetet ushtarake shtetërore. Ne pranvere te vitit 1918, docenti i arkeologjisë klasike ne Universitetin e Vjenës, nëntoger Kamilo Prashniker, i dërguar nga Akademia e Shkencave ka mbledhur objekte antike ne krahinën e Fierit, ne Manastirin e Pojanit dhe ne Ballsh 80 objekte i klasifikoi dhe i dërgoi ne Durres. e prej ketu ne Austri. (AIH, Vj.28-3-367).

Abaz Taushani eshte vlerësuar për aktin e tij atdhetar e heroik dhe dekoruar për "Veprimtari patriotike" nga Mbretëria Shqiptare por edhe me pas.

Për shkak te prejardhjes se tyre, Taushanët janë persekutuar gjatë regjimit komunist.

(Ky punim është realizuar në sajë të ndihmës se Xhevahir Taushanit një nga trashëgimtarët e familjes Taushani).

PS.

Fjala "taushan kady" kuptime te ndryshme ne gjuhen osmane, respektivisht; drugdhendës dhe lepur. Nga gojëdhënat ky mbiemër ka dy versione :

1. Versioni i parë kur Mehmet beu u emërua sanxhakbej i pare i Elbasanit, Sulltani i tha atij te qëndronte ketu ne gatishmëri, me veshët ngrëhur si lepur dhe te sinjalizonte me shpejtësi për çdo gjë Porten e Larte.

2. Sipas Selami Pulahës , i nipi i Gjergj Arianitit, Ali bej Taushani qeveritar ne Vlore ne 1526 -1527 emërohet sanxhakbej i Prizrenit. Mendohet se ato ka kryer nje vrasje te nje qeveritari dhe për të mos rene në duart e sulltanit. Iku me shpejtësitë madhe. Pas kësaj ngjarje, ate e thirren Taushan, i shpejte si lepur.

Deri ne një sqarim me te hollësishëm qe do të marrim nga arkiva turke, si shpjegim mbetet versioni i parë, i cili lidhet bash me kohen kur, Mehmet beu, i biri despotit (Gjergj Arianitit), ktheu fenë. Në këtë moment një dege e Arianiteve kthehet në Taushan.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Drejtoria e Përgjithshme e shërbimeve mbështetëse
Drejtoria e Shërbimeve Juridike
Spektori i Shpronësimeve

SHPALLJE KËRKËSE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private (tokë truall dhe objekte), që preken nga ndertimi i segmentit rrugor "Porto Romano - Durrës", loti i parë

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të Vendimit nr.138, datë 23.03.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Për të gjithë pronarët që pretendojnë pronësinë përkatëse të truallit dhe objektit, do të rikërkohet konfirmim pranë ALUIZNI-t.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentat përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 177 248 681 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) lekë.

DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

DREJTORIA E SHPRONESIMEVE

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I RRUGES
 "Porto Romano - Durrës".Loti pare

NR	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona Kadast.	Nr. Pasurise	Siperf. pergj.m	LLOJI I PASURISE					SHUMA (Leke)	Shenime
							TRUALL			OBJEKT			
							M ²	Çmim	Vl. (Leke)	(Lloji)	Vl. (Leke)		
1	Rifat	Rustem	Hoxha	8517	152/4	411	384	3600	1382400	banese 1kt	4739903	6122303	Rikonf. ALUIZNI
2	Qemal	Murat	Allamani	8517	152/2	487	223	3600	802800	banese 1kt	2053652	2856452	Rikonf. ALUIZNI
3	Baki	Fadil	Shenjтари	8517	152/93	386	122	3600	439200	banese 2kt	5526174	5965374	Rikonf. ALUIZNI
4	Skender	Hasan	Pepa	8517	152/25	381	255	3600	918000	banese 1kt	3761997	4679997	Rikonf. ALUIZNI
5	Tofik	Zenel	Bershini	8517	152/81	329	271	3600	975600	banese 1kt	3592437	4568037	Rikonf. ALUIZNI
6	Enver	Zenel	Bershini	8517	152/78	183	180	3600	648000	banese 1kt	2045952	2693952	Rikonf. ALUIZNI
7	Rifat	Bajram	Dibra	8517	152/199	448	188	3600	676800	banese 1kt	7671850	8348650	Rikonf. ALUIZNI
8	Ahmet	Hasan	Pisli	8517	152/46	512	286	3600	1029600	banese 1kt	3153007	4182607	Rikonf. ALUIZNI
9	Dritan	Izet	Hysa	8517	152/219	400	400	3600	1440000	banese 1kt	128008	1568008	Rikonf. ALUIZNI
10	Xhevdet	Hajredin	Kutriqi	8517	152/45	517	512	3600	1843200	banese 1kt	4333531	6176731	Rikonf. ALUIZNI
11	Leonard	Xhevdet	Kutriqi	8517	152/44	295	184	3600	662400	banese 1kt	257087	919487	Rikonf. ALUIZNI
12	Nezir	Hasan	Pepa	8517	152/27	439	421	3600	1515600	banese 1kt	4569924	6085524	Rikonf. ALUIZNI
13	Flamur	Vehap	Uka	8517	152/220	218	218	3600	784800	banese 2kt	9674245	10459045	Rikonf. ALUIZNI
14	Zeqir	Selam	Parllaku	8517	152/239	318	318	3600	1144800	banese 1kt	3520725	4665525	Rikonf. ALUIZNI
15	Ahmrt	Adem	Tufa	8517	152/243	294	294	3600	1058400	banese 1kt	3833594	4891994	Rikonf. ALUIZNI
16	Lavdrim	Rakip	Pisli	8517	152/62	210	210	3600	756000	banese 1kt	440811	1196811	Rikonf. ALUIZNI
17	Haxhi	Avdyll	Mulgeci	8517	152/198	304	304	3600	1094400	banese 1kt	4126312	5220712	Rikonf. ALUIZNI
18	Faik	Halil	Metra	8517	152/76	237	237	3600	853200	banese 1kt	218091	1071291	Rikonf. ALUIZNI
19	Hamide	Zenel	Kurmata	8517	152/94	480	148	3600	532800	banese 1kt	4842343	5375143	Rikonf. ALUIZNI
20	Haxhi	Mehmet	Dunisha	8517	152/197	304	236	3600	849600	banese 1kt	3970400	4820000	Rikonf. ALUIZNI
21	Uke	Rustem	Sula	8517	152/202	476	475	3600	1710000	banese 1kt	3467360	5177360	Rikonf. ALUIZNI
22	Oltjana	Sahit	Memaj	8517	152/296	397	91	3600	327600	banese 1kt	5000784	5328384	Rikonf. ALUIZNI
23	Ali	Zenel	Bershini	8517	152/83	430	250	3600	900000	banese 1kt	2096467	2996467	Rikonf. ALUIZNI
24	Ibrahim	Xhetan	Kalia	8517	152/96	286	282	3600	1015200	banese 1kt	2267753	3282953	Rikonf. ALUIZNI
25	Sulejman	Man	Topalli	8517	152/157	496	202	3600	727200	banese 1kt	2881425	3608625	Rikonf. ALUIZNI
26	Urim	Jaxha	Koliqi	8517	152/95	417	421	3600	1515600	banese 1kt	4261741	5777341	Rikonf. ALUIZNI
27	Veze	Myftar	Kalia	8517	152/97	314	106	3600	381600	banese 1kt	3845478	4227078	Rikonf. ALUIZNI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Drejtoria e Përgjithshme e shërbimeve mbështetëse
Drejtoria e Shërbimeve Juridike
Sektori i Shpronësimeve



SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

28	Shpetim	Aqif	Aliaj	8517	152/21	301	142	3600	511200	banese 1kt	239023	750223	Rikonf. ALUIZNI
29	Riza	Rustem	Huna	8517	152/138	300	300	3600	1080000	banese 1kt	3730765	4810765	Rikonf. ALUIZNI
30	Selim	Zenel	Gjedia	8517	152/180	341	341	3600	1227600	banese 1kt	4228039	5455639	Rikonf. ALUIZNI
31	Ymer	Zenel	Gjedia	8517	152/179	275	275,5	3600	991800	banese 1kt	3631344	4623144	Rikonf. ALUIZNI
32	Isuf	Halil	Katrarosh	8517	152/178	198	189	3600	680400	banese 1kt	3080292	3760692	Rikonf. ALUIZNI
33	Qemal	Avdi	Kurti	8517	152/237	300	300	3600	1080000	banese 1kt+1	3919152	4999152	Rikonf. ALUIZNI
34	Hajredin	Nazif	Miha	8517	152/134	517	515	3600	1854000	banese 1kt	2757638	4611638	Rikonf. ALUIZNI
35	Aranit	Rasim	Sokoli	8517	152/282	242	144	3600	518400	banese 1kt	197627	716027	Rikonf. ALUIZNI
36	Gezim		Prendi	8517	152/155		298	3600	1072800	banese 1kt	2503223	3576023	Rikonf. ALUIZNI
37	Mark		Biba	8517	152/297	422	422	3600	1519200	banese 1kt	2263324	3782524	Rikonf. ALUIZNI
38	Petrit	Nazir	Kola	8517	152/113	431	6	3600	21600	banese 1kt	2107327	2128927	Rikonf. ALUIZNI
39	Hasime	Shpend	Shkreli	8517	152/175	299	211	3600	759600	banese 1kt	1411947	2171547	Rikonf. ALUIZNI
40	Fatos	Adem	Kadiu	8517	152/64	272	76	3600	273600	banese 1kt	1821246	2094846	Rikonf. ALUIZNI
41	Hamdi	Ramazan	Alliu	8517	152/260	423	259	3600	932400	banese 1kt	2017142	2949542	Rikonf. ALUIZNI
42	Fatmir	Minush	Dajci	8517	152/181	166	10	3600	36000	banese 2kt	5199531	5235531	Rikonf. ALUIZNI
43	Shkelzen		Mehaj	8517	152/253	224	39	3600	140400			140400	Rikonf. ALUIZNI
44	Hysni		Shahini	8517	152/237	477	32	3600	115200			115200	Rikonf. ALUIZNI
45	Hasan		Ceka	8517	152/118	320,8	320,8	3600	1154880	banese 1 kt	1906130	3061010	Rikonf. ALUIZNI
	Shuma:						11098		39953880		137294801	177248681	

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I RRUGES

"Porto Romano - Durres".Loti pare(objektet qe preken nga ndertimi i rruges,por nuk jane konfirmuar nga ALUIZNI Durres)

NR	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona Kadast.	Nr. Pasurise	Siperf. pergj.m	LLOJI I PASURISE				SHUMA (Leke)	Shenime
							TRUALL		OBJEKT			
							M ²	Çmim	Vl. (Leke)	(Lloji)		
1	Ruzhdi	Aqif	Tasha	8517							837770	
2	Imer	Halil	Kataroshi	8517							3833141	
3	Tushe	Zenel	Pasha	8517							1337302	
4	Ilir	Shefki	Cani	8517							2135040	
5	Xhovalin		Aga	8517							1266587	
6	Mujo	Halil	Brati	8517							1105963	
7	Gjyle		Hasani	8517							81115	
8	Dritan	Mark	Nikolla	8517							225855	
9	Emine	Imer	Allaraj	8517							144072	
10	Ilir	Selam	Allaraj	8517							92659	
11	Bege	Selam	Allaraj	8517							951027	
12	Sadri	Mehmet	Gjidiaj	8517							3736528	
13	Islam		Pisli	8517							519225	
14	Burhan	Ibrahim	Kika	8517							1283993	
15	Haki	Osman	Cani	8517							1065439	
16	Kujtim		Kataroshi	8517							113506	
17	Artur		Hadroj	8517							183467	
	Shuma:										18912689	

Ka filluar fushata e abonimeve në gazetën "55". Ofertat e abonimeve janë:

1 muaj	900 lekë
3 muaj	2700 lekë
6 muaj	5400 lekë
1 vit	10800 lekë



Të gjithë të interesuarit që duan të abonohen në gazetën "55", të drejtohen pranë:

POSTA SHQIPTARE
AGJENSIA E SHPERNDARJES E
SHTYPIT 1, 2
ADRION LTD

tel : 04/2321364
cel : 0672135242

Qytetarë, biznesmenë, institucione, abonohuni në gazetën "55"!



Nga Morton Abramowitz
& James Hooper

(vijon nga numri i djeshëm)

Serbia kërkon të anëtarësohet në BE, por liderët europianë kanë përcjellë mesazhe të përziera - ndonjëherë duket se thonë që Serbia mund ta arrijë pranimin pa zgjidhjen e problemit të Kosovës. Në esencë, Qeveria Tadic ka vazhduar qëndrimin përjashtues për Kosovën të regjimit të mëparshëm të Kostunicës, por me një stil më të sofistikuar dhe të nuancuar, me të cilin ka fituar miq jashtë vendit. Serbia ka punuar shumë për ta ruajtur kontrollin mbi pjesën veriore të Kosovës - të përqendruar në qytetin e ndarë të Mitrovicës - kurse Perëndimi nuk ka bërë asgjë për ta parandaluar këtë gjendje që nga lufta e vitit 1999. Derisa shumë serbë janë lodhur me problemin e Kosovës dhe dëshirojnë që Qeveria të fokusohet në çështjet qendrore të jetës së tyre, klasa politike serbe ende është politikisht ngurruese të rrezikojë me ndryshimin e qasjes ndaj Kosovës. Zyrtarët e lartë serbë haptas e pranojnë se Kosova është e humbur për ta, por pohojnë se nuk mund të largohen nga Kosova "duarbosh". Për shkak të brengave politike të këtij lloji, Boris Tadic duhet ta finalizojë cilindo rezultat të negociuar para zgjedhjeve të ardhshme në Serbi, në prill 2012.

Maqedonia fqinje është një shtet me rrezikshmëri dhe potencialisht është më drejtpërdrejtë e prekur nga negociatat rreth Kosovës. Ajo mbetet e ndarë në mes të shqiptarëve të varfër dhe sllavëve pak më të pasur, pavarësisht Marrëveshjes së Ohrit që është arritur me vështirësi për ta kapërcyer hendekun mes tyre dhe për të krijuar një shtet politikisht të qëndrueshëm. Shpresa e saj që ta ruajë stabilitetin e brendshëm nëpërmjet pranimin në NATO u pengua nga refuzimi i Greqisë për të lejuar që ta përdorë emrin e saj zyrtar. Shqiptarët e Maqedonisë janë në kontakt të afërt me shqiptarët në Shqipëri dhe Kosovë, ndërsa bashkimi i shqiptarëve është në mendjen e shumë prej tyre. Për një kohë të gjatë, mes akterëve të Ballkanit ka qenë i pakundërshtueshëm fakti se çdo ndarje e Kosovës do të çonte në shpëputjen e Maqedonisë Perëndimore, të dominuar nga shqiptarët.

Perëndimi dhe menaxhimi i negociatave/BE dhe SHBA mbesin thellësisht të përfshira në rajon, por me trupa, financime dhe qeverisje më të vogël. Qasja e tyre gjatë dy dekadave të fundit ka qenë e vonuar dhe pragmatike - zgjidhja e problemeve një nga një. Daytoni i dha fund luftës, por e bëri këtë në kurriz të ndarjes së përhershme etnike që e ka penguar përparimin politik të Bosn-



Rehatimi i Ballkanit

Maqedonia fqinje është një shtet me rrezikshmëri dhe potencialisht është më drejtpërdrejtë e prekur nga negociatat rreth Kosovës. Ajo mbetet e ndarë në mes të shqiptarëve të varfër dhe sllavëve pak më të pasur, pavarësisht Marrëveshjes së Ohrit që është arritur me vështirësi për ta kapërcyer hendekun mes tyre dhe për të krijuar një shtet politikisht të qëndrueshëm.

Shpresa e saj që ta ruajë stabilitetin e brendshëm nëpërmjet pranimin në NATO u pengua nga refuzimi i Greqisë për të lejuar që ta përdorë emrin e saj zyrtar

jës, kurse lideri i entitetit serb haptas kërkon të pavarësohet. NATO-ja e çliroi Kosovën nga Millosheviçi, por, për ta respektuar Serbinë, gjatë krijimit të entitetit të pavarur i la të paqartë kufijtë territorialë të shtetit. BE-ja dhe SHBA-ja me çdo kusht kërkuar ta mbajnë Maqedoninë të bashkuar me anë të Marrëveshjes së Ohrit, por më pas e zhvendosën vëmendjen dhe nuk u angazhuan mjaftueshëm për ta ndihmuar shtetin të funksionojë më mirë. BE-ja ka zëvendësuar Shtetet e Bashkuara si arbitri kryesor në rajon sa i përket financimit dhe trupave, ndërsa shpresa për pranim në BE është mjeti kryesor për nxitjen e bashkëpunimit midis vendeve. Shumë njerëz frikësohen se BE-ja nuk është e aftë për ta zgjidhur çështjen e Kosovës, dhe jo vetëm për shkak të ndasive brenda Unionit rreth çështjes së Kosovës. Formula e BE-së për progresin në rajon ende mbetet për t'u testuar, ndërsa shpresat për pranim tash për tash janë tërhequr. SHBA-ja ka mbetur aktere kryesore vetëm në Kosovë - gjë që shpesh e ka hidhëruar BE-në, sepse populli i Kosovës e konsideron SHBA-në si të vetmin mik të besueshëm. Aktualisht, shtetet perëndimore po flasin për negociata, por janë duke

menduar në "bisedime teknike" për pasaportat, doganat, si dhe çështjet tjera midis Serbisë dhe Kosovës. Këto janë çështje të rëndësishme praktike që ndikojnë në jetesën e qytetarëve të tyre, por nuk kanë të bëjnë me çështjet më të gjera mes vendeve, dhe sigurisht jo me ato që janë prioritet i Qeverisë së Serbisë dhe asaj të Kosovës. Kohëve të fundit, çështja e ndarjes së Kosovës e ka fituar vëmendjen publike në të gjithë Ballkanin. Një problem me të cilin përballen negociatorët perëndimorë është se ndarja e Kosovës në këmbim të anëtarësimit të mundshëm në OKB, për një shtet të cunuar si ai i Kosovës, nuk është një propozim i tregtueshëm në Prishtinë. As Serbia nuk mund të presë që Perëndimi në këtë kohë t'i bëjë presion palës më të dobët - Kosovës - për t'i pranuar kushtet që janë më pak se kërkesat e saja minimale. Sfidat do të konsistojnë në përcaktimin e ekzistimit të fleksibilitetit të mjaftueshëm të pozicionit serb për të bërë negociatën, si dhe faktit nëse ka përfitim të mjaftueshëm për Serbinë në marrëveshje për ta mbrojtur Qeverinë prej kritikave të ashpra nga linja e ashpër opozitare, që është e parashikueshme.

Kjo nuk do të thotë se të dyja

palët nuk kanë asgjë për të fituar nga marrëveshja. Qeveria Tadic beson se nuk ka pse t'i frikohet negociatave që mund ta përgatisin ndarjen e Kosovës, t'ia lehtësojë hyrjen në BE, dhe t'ia heqë bashkësisë ndërkombëtare barrën e Kosovës Veriore. As për kosovarët bisedimet nuk janë vetëm humbëse. Shumica e kosovarëve preferojnë që kufijtë e tyre të mbeten ashtu si janë, edhe në qoftë se nuk i kontrollojnë, për t'i shmangur pasojat e ndryshimit të tyre. Por, ata nuk do të ishin kundër largimit të 40 mijë serbëve që jetojnë në veri të lumit Ibër, dhe ta mirëprisnin mundësinë e kthimit të një numri të shqiptarëve që jetojnë në Luginën e Preshevës, përgjatë kufirit lindor të Kosovës, pra, një shkëmbim territorial. Nëse bëhet vullnetarisht dhe paktohet si pjesë e procesit të normalizimit të raporteve me Serbinë, pa marrë parasysh shqetësimet perëndimore për natyrën e tij etnike, shumë kosovarë do të mund të konsideronin një shkëmbim të tillë më parë si forcim të shtetit të tyre të pavarur, sesa tradhti nga ana e Perëndimit. Por, kjo do të ishte kontroverze. Zyrtarisht, të gjitha partitë kryesore politike shqiptare të Kosovës janë kundërshtarë të shkëmbimit. Perëndimi do të

frikësohej se serbët në "enklavat" në jug gjithashtu do të iknin në Serbi. Pavarësisht kontroversës, shkëmbimi territorial mund të jetë rrethana e vetme nën të cilën humbja e veriut mund të jetë e pranueshme për Prishtinën dhe kështu ta sigurojë bazën për marrëveshje. Kjo është sugjeruar shpesh gjatë viteve të pasluftës, dhe është refuzuar nga Beogradi, por ka indikacione se tash është opsion i mundshëm. Beogradi duket se ende beson që mund ta rikëmbim Veriun pa ndonjë shkëmbim territorial. Qeveritë perëndimore do të duhet të pyesin veten se çfarë mund të arrihet realisht në këto negociata. Në fund të fundit, premtimi për pranim në BE duket gjithnjë e më i largët, dhe SHBA-ja ka mjaft punë të veta. Kalkulimet e gabuara politike janë më shumë rregull sesa përjashtim në Ballkan, dhe ka rrezik të konsiderueshëm që edhe diplomatët e përmbajtur dhe me përvojë ta fillojnë një proces që do t'iu eksplodojë në fytyrat e tyre. Me dy luftëra të papërfunduara dhe me problemin e Iranin që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme të nivelit të lartë, është pretencioze për Uashingtonin që të merret me këto çështje.

(vijon)

Rilindja e kombit grek

I. Ristrukturimi i shoqërisë greke

(Vijon nga numri i djeshëm)

Në këtë zonë qenë krijuar dy principata, në zanafillë shtete vasale të Hungarisë, ai i Vllahisë ose Hungrovllahisë diku aty nga fillimi i shekullit të katëmbëdhjetë nën Basarab-in (1314-52) dhe ai Moldavisë ose Moldovllahisë më 1359. Sundimtarët rumunë të këtyre shteteve, përkrahës të Kishës Ortodokse kishin rënë nën ndikimin e Bizantit dhe kishin marrë pjesë në qëndresën kundër pushtimit turk të Europës jug-lindore, duke u shkaktuar humbje të ndjeshme ushtarive turke, por aty nga fillimi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë të dyja principatat ishin shtrënguar të bëheshin tributarë të Sulltanit, ndonëse sipas disa kushteve të veçanta. 1 Princërit ishin të shtrënguar ta merrnin konfirmimin e zgjedhjes së tyre nga Sulltani, ose në disa raste emëroheshin drejtpërdrejt prej tij, dhe ashtu si të gjithë vasalët e tjerë lypsej të ofronin ndihmë ushtarake. Në këmbim përfitonin qeverisje autonome dhe një pavarësi relative të vendeve të tyre. Marrëveshjet që garantonin këto privilegje mbetën në fuqi deri në kohë të vona dhe ripërtëriheshin në mënyrë të vazhdueshme, siç ngjau, fjala vjen, pas ekspeditës së Sulejmanit I kundër Moldavisë në vitin 1358.

Pavarësisht nga shkeljet rastësore kjo marrëveshje e veçantë rezultoi tejet përfituese. Qysh në krye të herës u zhvillua një klasë e fuqishme sundimtarësh dhe disa prej sundimtarëve të dy principatave – Stefani i Madh (1457-1504), Neagoe Basarabi (1512-21), Mihail Trimi (1593-1601), Vasil Lupu (1634-53) – ishin burra vërtet të shquar. Ata qenë patronë të letrave, imponuan standardet e ligjit bizantin dhe në një sërë mënyrash u bënë shtyllë dhe mbështetje e Patriarkanës së Konstandinopojës si dhe e Kishës Greke. Ata qenë gjithashtu mirëbërës bujarë të manastireve të mëdha të themeluara në Malin Athos si dhe të manastireve të Meteoras, Malit Sinai dhe Patmosit. Nën patronazhin e princërve të Vllahisë dhe të Moldavisë qenë të shumtë ata klerikë grekë, studiues, artistë, administratorë dhe tregtarë që shkuan dhe u vendosën përtej Danubit. Vendi kishte shekuj që qe nginjur me traditën greke, ndaj dhe fillimet e Rumanisë moderne janë të lidhura me Bizantin. 2 Gërmime të kryera së fundmi në Kishën e bukur të Princit të Curtea de Arges, kanë nxjerrë në dritë monedha të Theodore Angelus (1224-30), Andronikus II (1282-1328) dhe Mihailit IX (1294-1320). 3 Në gjysmën e dytë të shekullit të katëmbëdhjetë në oborret rumune nisën të shfaqen bojarët e parë grekë. 4 Dyert e moçme të Bizantit dhe familjet e reja Fanariote krijuan lidhje me aristokracinë vendase e dinastitë e tyre princërore; eventualisht të dy fronët u bënë të kapshëm për klasën sunduese greke. Pa zënë ngoje këtu e përfshirë mes këtyre emrave endacakun James Vasilikos, i cili e mbylli jetën aventurore si Princ i Moldavisë (1561-63), mund të sjellim këtu Princërit Kankuzenë me prejardhje greke, Serban (1678-88) 1 dhe Demetrius (1674-5 dhe 1684-5).

Krijimi i hierarkisë në gjirin e Kishës greke kontribuoi gjithashtu jashtëzakonisht për të përhapur influencën greke. Më 1359 u caktua Metropolit i parë grek në Vllahi dhe midis viteve 1381 dhe 1386 në Moldavi. 2 Nga shekulli i shtatëmbëdhjetë arsimimi në greqisht organizohej në të dy vendet, ndaj dhe Theofilus Koridaleus, Panteleimon Ligarides dhe Ignatius Petrices ngritën dy qendra arsimore; Shkolla e Studimeve greke dhe latine në Tîrgoviste, në Vllahi dhe Shkolla e Tre Hierarkëve në Jasi (Iasi) në Moldavi, që të dyja më 1646. Këto i ndoqi më 1679, në Bukuresht, hapja e Shkollës së Princërve nga Serban Kantakuzeni. 3 Futja e sistemit arsimor të tipit Perëndimor Grek e Latin, eklipsoi traditën e vjetër të bazuar mbi Sllavishten. 4 Në këto kushte ndikimi grek ishte tanimë i madh në ato vende që grekët u thirrën të ushtronin detyrën e administratorit në emër të Sulltanit. Vendimi i qeverisë Osmane për të zëvendësuar sundimtarët vendas me administratorë grekë ishte i imponuar nga rëndësia e veçantë që përftuan provincat danubiane në dritën e ngjarjeve ndërkombëtare të parapakkohshme – luftrat e Pjetrit të Madh me Karlin XII të Suedisë si dhe kundër turqve, luftrat midis Turqisë dhe Venedikut, si dhe prirja e përgjithshme e politikave lindore të Fuqive të Europës Qendrore. Princët ru-



munë të Vllahisë dhe të Moldavisë, ndonëse padashje, ishin përfshirë në këto konflikte si dhe në problemet ndërkombëtare në përgjithësi, çka i ofroi Sulltanit vjengën për t'i dhënë fund sundimit të tyre dhe për t'i besuar Dragomanëve të Mëdhenj Grekë administrimin e viseve danubiane.

Mbretërimi i parë i Nikolla Mavrokordatit në Moldavi (ai mëtonte se e kishte prejardhjen nga një sundimtar i hershëm rumun i asaj principate nga ana e së ëmës) zgjati nga viti 1709 deri më 1710, mbretërimi i dytë nga 1711 deri më 1715, kohë kur u transferua në principatën e pasur të Vllahisë, më këmbë të Stefan Kantakuzenit, i cili mbretëroi vetëm pak muaj. Në vitin 1716 ai pati fatkeqësinë të binte rob në duart e austriakëve, asokohe në gjendje lufte me Turqinë, ndaj dhe u zëvendësua ad interim nga i vëllai, Joani. Gjithsesi në vitin 1719 e rifitoi sërish fronin dhe vijoi si Princ deri sa vdiq, më 1730. Në harkun kohor të viteve 1709 dhe 1821, njëzet e gjashtë princa fanariotë të familjeve të Mavrokordatëve, Gjikkave, Karaxha, Sucus, Muruzi, Kalimaqi, Ipsilanti, Rosetti dhe Mavrojani qeverisën dy territoret transdanubiane, me përjashtim të ndonjë intervale të shkurtër kohe, kur ato u gjendën nën pushtimin rus ose austriak.

Në fakt këta princër grekë ishin Guvernatorë të Përgjithshëm ose Mëkëmbës të mbretit të veshur me të gjitha fuqitë e mundshme administrative. Ata emëroheshin ose shkarkoheshin sipas vullnetit të sovranit të tyre, Sulltanit; por ngaqë ishin pasardhës të princërve vendas, ata morën prej atyre jo vetëm strukturën e përgjithshme të Oborrit princëror, tok me ofiqarët e lartë sipas shembullit të prijësve bojarë, por edhe disa të drejta sovraniteti, një pjesë të të cilave me miratimin e turqve e të tjerat pa dijen ose pëlqimin e tyre. Kësodore pavarësisht nga natyra e brishtë që kishte ofiqi i tyre, ata ia dolën të fusin fillesat e trashëgimisë në post dhe të themelojnë atë çka, në fakt nuk ishte gjë tjetër veçse dinastitë princërore. Po kështu ata punësuan trupa të rekrutuara nga popullsia vendase për të mbajtur rendin, nxorën dekrete dhe përmbledhje ligjesh, si dhe mbajtën marrëdhënie diplomatike me fuqitë e huaja.

Lypset të theksojmë këtu se, dekretet e nxjerra prej tyre nuk qenë thjesht e vetëm rregulla për të ujditur çështje

rutinore të qeverisjes së përditshme, por kishin të bënin me problemet madhore të bashkësisë dhe në disa raste shërbyen për të ndërmarrë reforma radikale sociale. Një shembull i jashtëzakonshëm ishte ai i Konstantin Mavrokordatosit, i cili sundoi Vllahi, me ndërprerje, gjithë-gjithë dymbëdhjetë vjetë, në periudhën midis viteve 1730 dhe 1748, si dhe tri herë në Moldavi (1733-5, 1741-1743 e 1748-9). Reformat e tij në fushën financiare, agrare dhe të taksave ishin një përpjekje e mirëfilltë për të qortuar padrejtësitë sociale dhe me veprimet e ndërmarrë në arsim si dhe në një sërë fushash të tjera e vendosin atë, siç shprehet një shkrimtar i kohës, në një radhë “sundimtarët e iluminuar të shekullit të tetëmbëdhjetë”. 2 Në sferën ligjore përmbledhjet më të plota të ligjeve të botuara përgjatë sundimit të princërve Fanariotë ishin: “Manual i ligjeve” i Mihail Foteinopullos (1765); (Përmbledhje e ligjeve) e Aleksandër Ipsilantit (1780); (Kodi Civil i Moldavisë) i Kalimaqit (1817); dhe (Kodi Civil i Vllahisë) i Karaxhas (1818). Në zhvillimin e marrëdhënieve diplomatike princërit grekë ndoqën precedentët e krijuar prej paraardhësve të tyre, duke mbajtur marrëdhënie të veçanta me oborret e Shën Petërburgut, Vjenës dhe Varshavës si dhe me një sërë personalitetesh politike të dorës së parë në pjesë të tjera të Europës. Pas traktatit të Kuçuk Kainarxhisë (Küçük Kainarca) të vitit 1774 mes Rusisë dhe Turqisë, pozita e princërve danubianë u forcua edhe më tej prej marrëdhënieve ndërkombëtare dhe, për rrjedhojë, veprimtaria e tyre diplomatike – e cila jo gjithmonë përputhej me interesat e Turqisë – u zgjerua ndjeshëm. Lidhur me veprimet e Princërve fanariotë dhe Dragomanëve grekë janë shprehur gjykime kundërthënëse.

Paparrhegopullos i afrohet këtij konstatimi kur vëren që arritjet e Fanariotëve në Principatat Danubiane qenë aq të mëdha sa ta përligjin pohimin se “sikur qeverisja e këtyre principatave të kishte vijuar të mbetej në duart greke përgjatë gjithë kësaj periudhe, kombi ynë mund të mburrej me fatkin se, ndonëse për vete ishte i skllavëruar, kishte kryer një bëmë heroike që rivalizonte me arritjet më të mëdha në kohën kur kish pasë qenë në kulmin e fuqisë së vet politike”.

Fund



BOTIM I SHTËPISË BOTUESE „55”

(vijon nga numri i djeshëm)

Kronika e MORESË

..... ✦ Përktheu: NASI LERA



Atë çast e mori fjalën njeriu më i urtë që ndodhej në këshillin e princit. Ai quhej Nikolas dë Sent-Omer. Ai ishte senjor i Tebës dhe kishte një përvojë të shquar. Duke iu drejtuar princit, i dha këtë këshillë: “Sire, në qoftë se doni t’ia arrini qëllimeve tuaja, me kusht që të ndiqni këshillën time, marr përsipër t’ia dal mbanë kësaj lidhjeje me mbretin Sharl. Është një e vërtetë e pakundërshtueshme, diçka e njohur prej të gjithëve: janë etërit tuaj dhe tanët ata që pushtuan Morenë, e thirrur që nga ajo kohë principatë, dhe ne e mbajmë vetëm sepse ata e fituan me mundime shumë të mëdha. Senjori ynë, babai juaj, nuk e mori këtë vend nga askush. Ai i detyrohet vetëm Zotit dhe shpatës së tij që fitoi senjorinë. Dhe kur kaloi nga jeta në vdekje, atëherë imzot Zhofrua, senjori ynë, vëllai ynë, u bë zot i saj. Ai mbajti pranë vetes vajzën e perandorit Robert¹⁸, i cili po e dërgonte ta martonte me mbretin e Aragonës, dhe, siç e di kushdo, u martua me të. Si dëmshtëpërbli ndaj perandorit, të cilin e kishte fyer dhe me qëllim që të jetonte në mirëkuptim me të dhe të ndreqte këtë konflikt, lidhi me të një marrëveshje që e bënte njeriun e tij besnik dhe e lejonte të mbante këtë vend vetëm me autoritetin e tij. Përderisa vëllai juaj veprroi në këtë mënyrë dhe përderisa u bë njeriu besnik i perandorit, nuk mund t’i shërbente, askujt tjetër përveç tij. Gjithashtu, me që ai veprroi vetëm në interes të tij, për të plotësuar dëshirën e tij dhe për të nxjerrë prej saj fitime, veproni po kështu dhe tani ndaj mbretit Sharl, për të plotësuar interesin tuaj dhe për të nxjerrë edhe ju fitime. Dhe nëse bëni këtë që them, unë do të kryej punën time: mbreti do të pranojë me gjithë zemër të lidhë aleancë familjare me ju.”

Mbreti dhe gjithë njerëzit e këshillit të tij qenë fort të kënaqur nga këto fjalë dhe bënë një lavdërim drithëruës. Me t’u dhënë këshilla që sapo tregova, të gjithë u rreshtuan pas atij gjykimi dhe iu përmbajtën atij. U cak-tua peshkopi i Olenës dhe imzot Pjeri (mbiemri i tij ishte dë Vo dhe atë e mbanin për një mendje të zgjuar në të gjithë principatën) si të dërguar pranë mbretit. Ata bënë përgatitjet e tyre dhe shkuan menjëherë në Brindisi. Sapo zbritën nga anija, blenë kuaj, u vunë për udhë dhe mbërritën te vendi ku ndodhej mbreti. Ata e gjetën në Napoli dhe u përlulën para tij. Ata kishin një letër që ia përcollën mbretit dhe që kërkonte qartë të kishte besim në të gjitha ato që do të dilnin nga goja e tyre.

Kur mbreti mori letrën dhe u njoh me thënien që e ftonte të kishte besim te të dy të dërguarit, i thirri të vinin për një takim të veçantë dhe i pyeti se ç’kishin për t’i thënë. Dhe ata, si burra të urtë që ishin, morën fjalën për t’i thënë me hollësi atë që i kishte çuar deri aty, dëshirën e princit për të pasur një lidhje afrie dhe për të qenë vetëm një me të, nëse të paktën Zoti dhe mbreti e pranonin. Kur mbreti dëgjoi mirë fjalët e tyre, iu përgjigj se do të këshillohej me këshillin e tij dhe pastaj do t’iu jepte përgjigje, siç e kërkonte zakoni.

Me të thënë këtë, mblodhi prijësit më të rëndësishëm dhe më të mirë të luftës që bënin pjesë në këshillin e tij. Ai u paraqiti me hollësi marrëveshjen që princi i Moresë i propozonte me shkrim për të përfunduar me të. Këshilltarët filluan ta rrihnin atë çështje dhe të merrnin një vendim. Nga diskutimet e tyre u arrit në përfundimin që të dërgonin dhe të gërmonin të dërguarit për të pasur të gjitha të dhënat e nevojshme. Ata i thirrën dhe filluan t’i pyesin, duke kërkuar si Gijomi, princi i Moresë, kishte siguruar senjorinë e tij, kë njohte ai si kryezot, ç’lloj vendi ishte Moreja, ç’ mund të sillte ajo. Ai që u përgjigj ishte imzot Pjeri, sepse dinte çdo gjë për Morenë.

Pasi mbreti, i rrethuar nga këshilli i

tij dëgjuan se ç’përbënte principata e Moresë dhe ç’vlerë kishte, të gjithë e këshilluan ta përfundonte për të mirë atë çështje, duke kuptuar dhe marrë me mend përparësinë që kishte. Atëherë mbreti pranoi të ndiqte mendimin e tyre. Kur dha pëlqimin e tij për atë aleancë me princin Gijom të Moresë, nisi për tek ai një peshkop, dy flamurmbajtës dhe dy kalorës të tjerë që bënin pjesë në shpurën e tij, për të njohur, nëpërmjet këtyre të dërguarve, përgjigjen dhe dëshirat e tij.

Ata u nisën për rrugë dhe arritën në Brindisi. Aty i gjetën anijet gati, u hipën atyre dhe mbërritën në Klarencë, para se të takonin princin në Andravidë. Peshkopi i Olenës dhe imzot Pjeri biseduan veças me princin dhe i raportuan rezultatit e takimit të tyre me mbretin. Pas kësaj, ata thirrën të vinin të dërguarit që mbreti Sharl kishte nisur së bashku me ta. Këta të fundit i thanë atë që kishin për t’i thënë princit të Moresë nga ana e mbretit Sharl. Ky i fundit ishte i prirur ta pranonte lidhjen familjare me kushtet e propozuara, ato që të dërguarit e tij i kishin paraqitur, domethënë që princi të shkonte të takonte mbretin në Napoli duke sjellë me vetë nga vajzat e tij, atë që ishte trashëgimtarja e tij, e quajtur Izabo, që biri i mbretit të merrte për grua vajzën e princit Gijom dhe që në fund princi të bënte aleancë dhe të pranonte të mbante vendin e tij nga mbreti Sharl¹⁹.

Princi i priti me kënaqësi propozimet, u bëri nderet më të mëdha atyre që ishin dërguar drejt tij dhe u dha dhurata. Të dërguarit morën rrugën e kthimit për të vënë në dijeni mbretin se princi i Moresë ishte dakord me pikat e marrëveshjes dhe se ishte gati të vinte

për ta mbyllur atë çështje. Princi nisi menjëherë të dërguar në ishullin e Euripesë që t’i sillnin një galerë të pajisur shumë mirë, ndër-sa urdhëronte që të bëhej gati edhe një tjetër në Klarencë. Ai bëri përgatitje siç i kishin hije një njeriu të rangut të tij. Pastaj u hipi galerave në shoqërinë e së bijës, Izabosë, dhe të shpurës së tij, duke marrë me vete aq kalorës sa e pa të nevojshme. Ata lanë Klarencën dhe arritën në Brindis. Me të zbritur në tokë, blenë kuaj, u nisën për udhë dhe udhëtuan deri në Napoli.

Kur mbreti u vu në dijeni se princi po i afrohej qytetit, i hipi dhe vetë kalit dhe doli ta takojë. Kur e takoi, e përshëndeti me dashamirësi, e kapi për dore, i bëri nderime që ngjallën admirimin e të gjithëve, pastaj të dy e bënë së bashku rrugën. Ata vunë këmbët për tokë sapo mbërritën në pallatin e mbretit, që e strehoi princin në qytet nëpër apartamentet e nderit. Ai e ftoi për darkë për të nesërmen dhe, për ta nderuar, ftoi të gjithë fisnikët që ndodheshin në Napoli. Ai bëri një pritje të madhe, e festoi ardhjen e princit, pastaj secili u tërhoq në apartamentin e tij.

Të nesërmen në mëngjes, princi erdhi dhe u paraqiti te mbreti për të biseduar me të. Mbreti thirri të gjithë kontët, që u mblodhën për të rrahur mendime dhe filluan të diskutojnë. Erdhën të dërguarit që kishin qenë te princi i Moresë. Ata paraqitën ç’kishte arritur misioni që mbreti u kishte besuar për të lidhur me princin një lidhje familjare, deri në ç’pikë kishin mundur ta çonin atë çështje. “Përderisa kështu desh mbreti i Lavdisë, përderisa princi erdhi deri këtu në tokat e Madhërisë Suaj dhe çështja është në duart tuaja, të ju të dyve, im-

zotër, zgjidheni për të mirë në mënyrë të tillë që ajo të kthehet në përparësi të dy senjorive tuaja dhe të ndihmojë në lavdinë dhe në paqen e popujve tuaj.”

Me të mbaruar të dërguarit ç’kishin për të thënë për atë aleancë, princi mori fjalën dhe tregoi si kishte rrjedhur çështja dhe si, duke iu përgjigjur dëshirës dhe urdhrat të mbretit, ai kishte ardhur së bashku me vajzën e tij. Ai ishte gati të vinte në jetë të gjitha ato pika mbi të cilat të dërguarit dhe ai vetë kishin qenë të një mendjeje dhe i kishin mbyllur mi-dis tyre.



Atëherë u përgjigj dhe vetë mbreti. Ai besonte në çiltërsinë e fjalëve të thëna nga princi dhe se ishte, nga ana e tij, i prirur për ta mbyllur atë çështje sipas pikave të marrëveshjes. Për këtë rregulluan dispozitat kryesore dhe urdhëruan të thirren fëmijët. Kryepeshkopi i Napolit, që kishte rangun e mitropolitit²⁰, kurorëzoi atëherë fejesën e dy të rinjve, e cila u ndoq shumë shpejt nga martesja e tyre²¹. Sepse princi i bëri nderimet mbretit Sharl, në emër të të cilit do të drejtohej tashmë vendin e tij. Ai hoqi dorë nga pushteti i kryezotit, ia dorëzoi mbretit, që ngarkoi më pas djalin e tij, imzot Luigjin, me detyrën e principatës²². Ky i fundit ia dha vendin të vjehrrit, që ta qeveriste deri në fund të jetës.

Me t’u rregulluar çështja që kujtova, princi qëndroi edhe pesëmbëdhjetë ditë pranë mbretit Sharl. U bënë festa të mëdha. Atëherë princi mori lajme nga Moreja: një nip i perandorit kishte mbërritur në Monemvassia me një ushtri të përbërë nga kumanë, turq dhe grekë, të ardhur nga rajoni i Nikesë dhe banorët e Moresë, të frikësuar, i kërkonin princit të kthehej. Princi shkoi të takonte mbretin dhe i tha me hollësi lajmet që kishte marrë. I kërkoi lejë të largohej dhe u kthye në More për t’i dalë krahu popullit të tij, për të mbrojtur vendin e tij dhe për të furnizuar fortifikatat. Mbreti i tha se ishte detyra e tij të kthehej në shtëpinë e vet për të mbrojtur Morenë dhe për ta mbrojtur nga armiqët e saj. Atëherë princi mori lejë nga mbreti dhe u largua. Ai shkoi në Brindisi me kalë me ngutjen më të madhe, gjeti aty galerat e tij të gatshme për të marrë detin. U nis me to dhe për dy ditë mbërriti në Klarencë, prej nga shkoi në Andravidë.

Të gjithë banorët e Moresë, kur mësuuan kthimin e princit, u mbushën tërë gëzim dhe guxim ndaj armiqve të tyre. Princi u dërgoi të gjithëve letra, ku u thoshte që të qëndronin të gatshëm së bashku me garnizonet e tyre; vetë ai do të bashkohej me ta për t’i ndihmuar; ndërkohë, duke pritur, duhej të furnizonin kështjellat, të mobilizonin trupa dhe të mbronin vendin dhe kufijtë e tij. Pasi pushoi katër ditë, u shkroi prijësve të luftës dhe kalorësve të mblidheshin sa më shpejt tek ai. Me ta, vizitoi të gjitha fortesat dhe u kujdes që ato të kishin një garnizon të mjaftueshëm për të prapsur armikun.

Po e ndërpres këtu bisedën për princin Gijom për t’ju folur për mbretin Sharl, për aksionin që kreu dhe për dhembshurinë që shfaqti ndaj princit të Moresë. Ky mbret tepër i matur, tërë dashuri për të afërmin e tij, princin Gijom dhe i zoti në artin e luftës, sapo princi u nda prej tij, përsiati dhe kuptoi se, përderisa perandori kishte dërguar ushtrinë e tij në More për të luftuar princin, të afërmin e tij, ky i fundit kishte nevojë për përforsime të mëdha për të mbrojtur vendin e vet. Ai thirri atëherë një nga kalorësit e tij, që ishte një ushtar i regjur, imzot Galeran d’Ivri²³, dhe i tha: “Dua që të shkoni në More për të ndihmuar aty princin, të afërmin tim, në shoqërinë e njëqind kalorësve mercenarë, dyqind këmbësorëve dhe nga një grup shqytarësh. Ju kërkohet që t’i paguani për gjashtë muaj dhe ju emëroj në krye të tyre, si guvernator dhe kapiten.

(vijon)



Albania A New Mediterranean Love

Dashuri e re Mesdhetare

Shqipëria, pasioni i përjetshëm i kthimit në shtëpi

